AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

# RAPORTI
# I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

**Programi i Integruar i Studimit të Ciklit të Dytë "Master i Shkencave"**

**në "Arkitekturë dhe Dizajn Urban"**

**"Universiteti POLIS"**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof.as.Dr. Florim Grajcevci

Dr. Gjergji Islami

Qershor/2022

**TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**

**Për Programin e studimit: Master i Shkencave të Integruar "Arkitekturë dhe Dizajn Urban"**

| Nr. | | |
|---|---|---|
| 1 | IAL aplikues: | "Universiteti POLIS" |
| 2 | Njësia bazë që e ofron: | Fakulteti i Arkitekturës dhe Dizajnit. |
| 3 | Emërtimi i programit të studimit: | Master i Shkencave të Integruar në Arkitekturë dhe Dizajn Urban |
| 4 | Urdhri/VKM i licencimit: | UMASH Nr. 102, datë 24.04.2009 |
| 5 | Urdhri/VKM i riorganizimit: | - |
| 6 | Forma e regjistrimit të diplomës: | Urdhër Nr. 171, datë 11.06.2019 |
| 7 | Urdhri/VBA i akreditimit të parë: | UMAS Nr. 268, datë 20.05.2016 |
| 8 | Cikli i studimit: | Cikli i dytë |
| 9 | Kohëzgjatja e programit të studimit: | 5 vite/ 10 semestra |
| 10 | Kreditet në total (ECTS): | 300 ECTS |
| 11 | Forma e studimit: | Me kohë të plotë |
| 12 | Gjuha (shqip/tjetër): | Shqip |
| 13 | Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera: | JO |
| 14 | Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin): | JO |
| 15 | Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin): | JO |
| 16 | Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve: | Niveli 7 |
| 17 | Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit: | 21/4 |
| 18 | Numri i studentëve (për pese vite): | 136 |
| 19 | Komente / të tjera: | |

## TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i studimit Master i Shkencave Master i Shkencave të Integruar në Arkitekturë dhe Dizajn Urban ofrohet nga Fakulteti i Arkitekturës dhe Dizajnit, Universiteti POLIS, Departamenti Arkitekturë dhe Inxhinieri.

Me VKM nr. 698, datë 11.10.2006, "Për dhënien e lejes për hapjen e shkollës së lartë universitare, jopublike, Universiteti Polis" dhe udhëzimit nr.30 datë 26.09.2007 lidhur me hapjen e procedurave për programet e studimeve në ciklin e parë dhe të dytë, shënohen fillimet e punës së IAL.

Me VKM nr. 5882/1 të datës 08.11.2012, miratohet ndryshimi i statusit të Institucionit privat të arsimit të lartë "Shkolla e lartë private "Universiteti Polis" nga shkolla e lartë universitare në Universitet.

Me vendimin nr. 102 të datës 24.04.2009 miratohen programet e studimeve me ndryshime për cilin e parë dhe të dytë, nga studime të ciklit të parë në studime të Integruara me kohëzgjatje 5 vite të ciklit të dytë në të cilin vendim përfshihet programi i studimeve Arkitekturë dhe Dizajn Urban.

Akreditimi i fundit i programit të studimeve MSc i Integruar në Arkitekturë dhe Dizajn Urban është i arritur me vendimin MASM, nr. 268, datë 20.05.2016, i cili zhvillohet në 10 semestra (5 vite studimi) me 300 ECTS kreditë, në formë të studimit të plotë.

Akreditimi periodik IAL Universiteti "POLIS" me vendimin e Bordit të Akreditimit të ASCAL nr 113 të datës 15.12.2017 është për 6 vite (14.12.2023) dhe organizohet me njësitë kryesore:

**Fakulteti Arkitekturë dhe Dizajn**

Departamenti Art dhe Dizajn

Departamenti Arkitekturë dhe Inxhinieri

Qendra Kërkimore në Arkitekturë, Inxhinieri dhe Dizajn

**Fakulteti Planifikim, Mjedis dhe Menaxhim Urban**

Departamenti Planifikim dhe Menaxhim Urban

Departamenti i Mjedisit

Qendra Kërkimore e Qëndrueshmërisë

**Fakulteti për Kërkim dhe Zhvillim**

Departamenti i Kërkimit Shkencor

Departamenti i Kërkimit të Aplikuar

Qendra e Burimeve dhe Informacionit

**Qendra Studimore Ndërdiciplinore Kërkimore e Inovacionit**

Programi i studimit MSc i Integruar për Arkitekturë dhe Dizajn Urban organizohet nga Departamenti Arkitekturë dhe Inxhinieri i ndihmuar edhe nga Departamentet tjera të njësive tjera akademike të IAL, përkatësisht nga Fakulteti Arkitekturë dhe Dizajn i filluar nga viti 2006 me 41 studentë të regjistruar, ndërsa në vitin 2021-2022 janë 980 student aktivë.

**SHKALLA E PËRMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I FUNDIT**

Mbështetur ne vendim nr. 120, datë 18.02.2016 për akreditimin periodik të programit të studimit të ciklit të dytë, master i shkencave i integruar në "arkitekturë dhe dizajn urban" të universitetit "polis" si dhe *Aneksi Nr.18,* nuk përmban asnjë rekomandim. Ndërsa IAL pranon se ka te evidentuar disa sugjerime nga ekspertet e jashtëm te cilat mund te numërohen si:

- Sistemi i tutoraiatit, për të cili IAL reflekton në organizim të punës me studentet.
- Hartimi i dispensave për secilën lende mësimore, ku IAL përveç tjerash ka abonim ne dy biblioteka e-library (Jstor dhe Ebsco)
- Bashkëpunimet akademike, IAL ka projekte ndërkombëtare si Erasmur +, Mobiltetet e studenteve, programet e studimeve të ciklit të tretë të studimeve *Aneksi Nr.34*.

## PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

ASCAL ka përcaktuar kohën dhe grupet e vlerësimit të jashtëm për vlerësimin e programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave i Integruar në "Arkitekturë dhe Dizain Urban".

Bazuar ne VKM nr. 109 date 15.02.2017, me vendimin nr.prot 27 te datës 14.01.2022, ASCAL përcakton grupin e eksperteve për vlerësim ne përbëje nga:

- Prof. Ass. Dr. Florim Grajcevci
- Dr. Gjergj Islami

Gjatë gjithë procedurës GVJ është asistuar nga Koordinatori Teknik i ASCAL, MSc. Juna Mengri.

Përmes sistemit të ASCAL, ekspertëve të jashtëm ju vu në dispozicion i gjithë dokumentacioni i dorëzuar nga institucioni për vlerësimin e programit të studimit.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit ekspertët përgatitën draft raportin dhe hartuan një gamë pyetjesh të cilat ndihmuan në qartësimin e disa pikave dhe problematikave të këtij raporti.

Gjatë vizitës së kryer në Universitetin POLIS, në datat 21-22 Shkurt 2022, u zhvilluan një sërë takimesh mes grupit të vlerësimit të jashtëm dhe përfaqësuesve të Universitetit POLIS. Këto takime u shoqëruan me diskutime intensive dhe në përfundim të tyre GVJ hartoi raportin e mëposhtëm, i cili paraqet mendimet e ekspertëve të jashtëm mbi këtë program studimi.

Më datë 24.05. 2022, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 45/11 Prot., datë 24.05. 2022, dërgohet në Institucion Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm. IAL, shkresë zyrtare Nr. 430/1 Prot., datë 31.05.2022, regjistruar në ASCAL me Nr. 45/12 Prot., datë 01.02.2022, përcjell komentet mbi Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm. GVJ, pasi shqyrtoi me seriozitet komentet e IAL, shprehet si vijon:

***Komenti i institucionit:*** Referuar komentit të GVJ mbi ngarkesën e lartë të personelit akademik (RVJ faqe 23) sqarojmë se ngarkesë e tillë vihet re, vetëm në raste shumë të izoluara të personelit akademik në rolin e asistentëve, ku angazhimi në mësimdhënie është në mbështetje të titullarit të lëndës, i cili mban peshën kryesore të ngarkesës akademike. Në shumicën dërmuese të rasteve të tjera, ngarkesa e personelit akademik është brenda normave.

***Komenti i ekspertwve:*** Universiteti pranon mbingarkesën e personelit akademik (kryesisht asistent lektorë), e cila në disa raste rezulton përtej normave të pranueshme për të garantuar cilësinë. ***Raporti nuk pëson ndryshime.***

***Komenti i institucionit:*** Jemi në të njëjtn linjë me komentin e GVJ mbi rritjen e fondit të lëndëve me zgjedhje (RVJ faqe 24). Procesi i shtimit t ofertës së lëndëve me zgjedhje është nisur tashmë dhe vitin a ri akademik kjo ofertë do të pasurohet më tej.

***Komenti i ekspertwve:*** Universiteti pranon komentet mbi numrin e lëndëve me zgjedhje. ***Raporti nuk pëson ndryshime.***

***Komenti i institucionit:***Në lidhje me komentin për mbulimin e plotë të ngarkesës mësimore në vitin e katërt dhe të pestë, me personel akademik që ka të paktën gradën shkencore Doktor (RVJ faqe 26), sqarojmë se të gjithë titullarët e lëndëve të vitit të katërt e të pestë zotërojnë të paktën gradën

shkencore Doktor. Bashkëlidhur këtij dokumenti do të gjeni programin mësimor i cili ka qenë gjithashtu pjesë e dokumentacionit mbështets të RVB, (aneksi 14).

***Komenti i ekspertwve:*** Komenti i universitetit i referohet titullarëve të lëndës, ndërkohë që ligji 80/2015 (Neni 59, pika 6) i referohet personelit akademik që përfshihet në mësimdhënie, ku përfshihen kategoritë asistent lektor, lektor dhe profesor. ***Raporti nuk pëson ndryshime.***

***Komenti i institucionit:*** Në lidhje me publikimin on-line të raportit vjetor të NJBSC (RVJ faqe 70), Universiteti POLIS ka qenë gjithmonë transparent brenda komunitetit të tij të dhënat e raportit vjetor të NJBSC por për ta bërë transparent këtë raport edhe për publikun e gjerë, dakortësohemi për ta publikuar në faqen tone në web.

***Komenti i ekspertwve:*** Universiteti pranon komentet mbi publikimin e raportit të NJBSC. ***Raporti nuk pëson ndryshime.***

***Komenti i institucionit:*** Në vazhdim të të njëjtit standard, GVJ sugjeron hartimin e rekomandimeve dhe planeve të veprimit si pjesë e raportit vjetor të NJBSC (RVJ faqe 70). Sqarojmë se deri më sot, vlerësimet e marra nga pedagogët kanë qenë relativisht pozitive dhe përherë mbi vlerën katër prej pesë pikëve totale të mundëshme. Për këtë arsye, nuk ka qenë e nevojshme që të merren masa apo të hartohen plane masash për të frenuar fenomene negative.

***Komenti i ekspertwve:*** Jemi dakord me komentin e universitetit përsa i përket interpretimit të ngushtë mbi Kriterin 3 të Standardit VI.5, por GVJ gjykon se veprimi për sigurimin e cilësisë nuk aktivizohet vetëm në rastin e evidentimit mangësive apo problematikave, por realizohet përmes një procesi të vazhdushëm. Në këtë kuadër, sugjerimi synon të nxisë procese të vazhdueshme që nuk limitohen vetëm në shmangjen e problematikave por në promovimin e ekselencës. ***Raporti nuk pëson ndryshime në përmbajtje.***

**Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave i Integruar "Arkitekturë dhe Dizajn Urban"**

## I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER I SHKENCAVE /MASTER I ARTEVE

| **Standardi I.1**<br>**Institucioni i arsimit të lartë ofron program studimi "Master i shkencave", në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni ofron program studimi "Master i shkencave" që nuk bien ndesh me interesat kombëtare. | Mbështetur në Statutin e IAL (RVB; EV.2, neni 2, 3), misioni dhe vizioni i Universitetit POLIS përfshin: *Ofrimin ekselence ne edukimin e profesionisteve dhe kërkueseve shkencore te afte për te adresuar nevojat e tregut dhe shoqërisë ne fushat e interesit ne vend dhe jashtë tij. Te pajise studentet me cilësi e lidershipit profesional ne fushat qe mbulon ne mënyrë qe te ushtrojnë influence për zhvillim pozitiv te vendit dhe rajonit, te kryejnë aktivitete kërkimore, shkencore dhe praktike te lidhura me veprimtaritë akademike ne programet e studimeve, aftësi dhe njohuri teorike dhe praktike sipas standardeve më të larta bashkëkohorë. Objektivat e përcaktuara qe te formoj specialist te larte dhe shkencëtare te rijnë ne fushat e Dizajnit, arkitekturës dhe Inxhinierisë, shkencave te territorit, menaxhimit dhe politikave te zhvillimit.*<br><br>Nga vizita në institucion si dhe nga dokumentacioni i ofruar mbështetës i IAL, u konstatua se Programi i studimit Master i Shkencave i Integruar në "Arkitekturë dhe Dizain Urban" është hartuar në përputhje me Statusin e Universitetit, nenet 2, 3, vizioni dhe misioni i institucionit. Është program studimi i cili përputhet edhe me kornizat ligjore të vendit dhe kompetencat që ofrohen.<br><br>***RVB; Aneksi Nr.2; Aneksi Nr.3*** |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit "Master i shkencave" synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare. | Programi i studimit për Master i Shkencave i Integruar në "Arkitekturë dhe Dizajn Urban" është i akredituar ne vitin 2016. Ky program studimi organizohet në pesë vite studime duke diplomuar studentet me titull Master Shkencor me 300 ECTS sipas kartës së Bilonjës. Për vitet e kaluara ky program tani më ka një konsolidim të mirë të punës akademike nëpërmjet stafit akademik dhe administratës dhe se interesat e zhvillimit të programit të studimit shkojnë në interes të vendit duke pas një produkt i cili konsiderohet i nevojshëm për vendin. Ka plot aktivitete te cilat edhe shfaqen ne raportin vjetor te IAL-se. Efekt i IAL lidhur me synimin e ruajtjes dhe konsolidimit të vlerave akademike, kulturore dhe kombëtare dëshmohet me marrëveshjet e bashkëpunimeve që ka institucionet e vendit dhe jashtë.<br><br>***RVB; Aneksi Nr.17*** |
| **Kriteri 3.** Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e | IAL ofron një diversitet të programeve të studimeve të niveleve themelore BSc si dhe Master Shkencor, Master Profesional, të cilat mbulohen në mënyrë joformale, duke filluar nga Statuti deri te organizimi i realizimit të |

| | |
|---|---|
| veprimtarisë. | tyre. Programi i studimit Master i Shkencave i Integruar në "Arkitekture dhe Dizajn Urban", takojnë Fakultetit të Arkitekturës dhe Dizajnit të Universitetit POLIS.<br><br>Me kompetencat e fituara pas diplomimit studenti mund të vazhdoj në tregun e punës ose edhe në studimet e mëtejme më të thelluara. Duke qenë të qarta objektivat e përgjithshme të programit si dhe objektivat më të detajuara të lëndëve të programit të cilat kanë target tregun e punës në nivelin lokal dhe ndërkombëtar, ato sigurojnë edhe mundësin e studimeve dhe njohurive tjera shtesë.<br><br>Në fushat e Veprimtarisë të përcaktuara edhe nga Statuti i Universitetit gjenden të përcaktuara edhe fushat e inxhinierisë. Ndërsa misioni i IAL është në shërbim të programeve të studimeve dhe mbi këtë bazë janë të funksionalizuara edhe kurrikulat e tyre duke zhvilluar aktivitete akademike dhe duke prodhuar produkte në përputhje të plotë me qëllimet e Institucionit.<br><br>*RVB: Aneksi Nr.2; Aneksi Nr.52.1* |
| **Kriteri 4.** Programi i studimit "Master i shkencave" hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar. | Shkencat e Arkitekturës dhe Dizajnit Urban qe lidhen me Inxhinieri janë promotor i zhvillimit të vendit ndërsa konsiderohen kuadro potenciale për tregun e jashtëm dhe sidomos Evropian. Janë shumë veprime të IAL të cilat mund të klasifikohen si nxitëse për të ofruar tregut të punës kuadër të qëndrueshëm. Kjo u vërtetua nga grupi i vlerësimit të jashtëm gjatë vizitave në Institucion në takimet me Studentët e këtij programi të studimit "Master Shkencor i Integruar në Arkitekturë dhe Dizajn Urban" si dhe Stafin akademik të Institucionit bartës të lëndëve të programeve të studimit.<br><br>*RVB: Aneksi Nr.34* |
| **Kriteri 5.** Programi i studimit "Master i shkencave" krijon baza të qëndrueshme njohurish për studime të thelluara të ciklit të tretë, duke përfshirë aftësimin e thelluar profesional e shkencor | Sipas kurrikulës të programit të studimit "Master Shkencor i Integruar në Arkitekturë dhe Dizajn Urban" për cilin kërkohet të riakreditohet, vlerësohet se përmbajtja e lëndëve brenda viteve të studimeve është e sistemuar në atë mënyrë që të krijohen vlera profesionale si dhe bazë të qëndrueshme të njohurive të thelluara shkencore për fushat e Arkitekturës dhe Dizajnit Urban. Lëndët që i takojnë fushës së Arkitekturës sikur janë Studiot 1 deri 6, pastaj studio të dizajnit Urban garantojnë arritje të qëndrueshme të studentit për mundësi vazhdimi të mëtejme shkencore dhe padyshim edhe profesional duke gjatë projektimit, ndërtim, Vlerësim etj.<br><br>*RVB, Aneksi Nr.52.1* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| Standardi I.2<br>**Programi i studimit MSH është në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni përcakton qartë se programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit. | IAL ka të miratuar Strategjinë e zhvillimit të miratuar nga Senati Akademik për periudhën 2021 deri 2026. Në këtë dokument të aprovuar është e qartë se Universiteti së bashku me njësitë e veta akademike është i përcaktuar për programe akademike të avancuara dhe bashkëkohore në mënyrë që të joshë studentët duke pas prioritet ndërkombëtarizimin institucional. Në strategji përkufizohen nga IAL fushat për të cilat Universiteti për periudhën pesëvjeçare do te synoj të arrijë mbështetur në Misionin dhe Vizionin, për Strategjinë Didaktike, Hulumtuese, Ndërkombëtarizimin, digjitalizimin, sipërmarrjen si dhe rritjet financiare.<br><br>Programet e studimit për riakreditim mbështeten në konceptet themelore të strategjisë institucionale të zhvillimit.<br><br>*Aneksi Nr.3* |
| **Kriteri 2.** Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimet prioritare akademike të tij dhe demonstrojnë se programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit. | Universiteti POLIS, brenda ligjeve të vendit, ndërsa Statuti konsiderohet shtylla Juridike e Institucionit, e cila është e miratuar nga Senati Akademik i Universitetit POLIS së bashku me rregulloret funksionale, të cilat përmbushin spektrin ligjor të IAL-së dhe janë brenda Statutit. Statuti përshkruan organizimin e studimeve brenda njësive të veta, kriteret për studime në nivelin e ciklit të parë, dytë dhe ciklit të tretë të studimeve.<br><br>Ka një numër të konsiderueshëm të rregulloreve funksionale të miratuara nga Senati Akademik i Universitetit POLIS (rregullorja e përgjithshme e Universitetit, Rregullorja e Fakultetit te Arkitekturës dhe Dizajnit si dhe Rregullorja e programit te studimeve MSc ADU) të cilat rregullojnë programe të studimeve si dhe funksionimin e zyrave, njësive akademike dhe të tjera. Ekziston rregullorja e Fakultetit të Arkitekturës dhe Dizajnit, e cila përveç tjerash përcakton qartë çështjet lidhur me programet e studimeve, mënyrën e organizimit të aktiviteteve akademike për realizimin e qëllimeve, vizionit dhe misionit të përcaktuar të Institucionit.<br><br>Programi i studimit "Master Shkencor i Integruar në Arkitekturë dhe Dizajn Urban" është krijuar mbi këto baza ligjore të Institucionit dhe nga gjetjet e Grupit të vlerësimit të jashtëm, gjatë takimeve me grupe të caktuara sipas agjendës konstatohet se zbatimi i programit të studimit është në përputhje të plotë me dokumentet relevante të Institucionit.<br><br>*Aneksi Nr.2; Aneksi Nr.5, Aneksi 6, Aneksi 7.* |
| **Kriteri 3.** Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimet akademike të institucionit. | Për Universitetin POLIS, konsiderohet se programi i studimit për Arkitekturë është nismëtar dhe se Statuti i IAL-së përmban gjithashtu fushat e Arkitekturës, ndërsa emërtimi i programit të studimit i cili ofrohet nga IAL për MSc Arkitekturë dhe Dizajn Urban është tregues i ekzakt i përcaktimit të fushave. Ky program i studimit MSc ADU, organizohet nga Fakulteti i Arkitekturës dhe Dizajnit me fusha në përputhje të plotë.<br><br>*Aneksi Nr.2; Aneksi Nr.5, Aneksi 6, Aneksi 7.* |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 4.** Programi i studimit “Master i shkencave” hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit | Strategjia e hartuar e IAL-së dhe strategjia e axhendës së kërkimeve shkencore e cila përmbanë tri fusha në konceptin e zhvillimit të sajë, duke insistuar në përmirësimin e vazhdueshëm dhe konsolidimin e kurrikulave ekzistuese, diversiteti i ofertës akademike dhe edukimi dual si ndërlidhje e kërkimit dhe mësimdhënies janë bazament për hartimin dhe zhvillimin e programit të studimit MSc ADU.<br><br>Emërtimi i programit të studimit është vendosur në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar me Nivelin e 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimit.<br><br>*RVB, Aneksi Nr.2* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [redacted] | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi I.3**<br>**Programi i studimit “Master i shkencave” synon të plotësojë nevojat e tregut të punës dhe ofrohet në përputhje me kërkesat e tij.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Programi i studimit “Master i shkencave” ka objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë njohuritë e thelluara shkencore, aftësitë dhe kompetencat profesionale, që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato dhe me kërkesat e tregut të punës. | GVJ konsideron se nga të gjitha dokumentet në dispozicion nga IAL si dhe nga vizitat e zhvilluara në takime të ndryshme programi i studimit MSc ADU ka të qartësuar Objektivat e saja edhe përmes dokumenteve, sikur është rregullorja për programin e studimit që përcakton veprimtarinë formuese në thellimin e ekspertëve arkitekt duke krijuar alternativ të re të studimeve në këto fusha.<br><br>Programi i studimeve MSc ADU është i integruar dhe zhvillohet në pesë vite (10 semestra) duke mbledhë studenti 300ECTS.<br><br>Kurrikulat e programit të studimit sipas profileve përbëhen nga lëndët të cilat janë të organizuara sipas parimeve “Bloom Pyramid”. Lëndët e ofruara, përkatësisht përmbajtjet e syllabuseve të tyre i ofrojnë studentit që të fitoj njohuri të avancuara shkencore përkatësisht formim profesional i cili gjen zbatim në tregun e punës si dhe mundësi e vazhdimit të studimeve në ciklin e tretë. Finalizimin e studimeve, programet e kurorëzojnë me punën praktike si dhe me punimin e diplomës.<br><br>GVJ konsideron se këto objektiva në pjesën më të madhe në programin e studimit MSc ADU arrihen përmes organizimit të lëndëve në kurrikulën e programeve të studimeve duke përgatitur specialist të lartë të fushave të Arkitekturës dhe Dizajnit Urban.<br><br>Programi i Studimit MSc ADU, pajisin studentët me njohurit e thelluara shkencore të fushave profesionale për projektimin, zbatimin, menaxhimin e ndërtimit dhe vlerësime profesionale të aktiviteteve Arkitektonike.<br><br>*RVB, Aneksi Nr. 7* |
| **Kriteri 2.** Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për | GVJ i janë vënë në dispozicion disa raporte me të dhëna studimore mbi numrin e pranimeve në IAL që ofrojnë studime në arkitekturë dhe dizajn |

| | |
|---|---|
| programin e studimit që ofron përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës. | urban.<br><br>Për studimin e tregut përpara hapjes, institucioni deklaron se është pjesë e dosjes së licencimit, pa sqaruar nëse një dokument / raport i plotë disponohet ose jo.<br><br>Vihet re që dokumentacioni i paraqitur për studimin e tregut aktual fokusohet kryesisht tek "tregu" universitar dhe nuk trajton tregun e punës për studentët.<br><br>Gjithsesi, IAL ka dokumentim mbi të dhënat e punësimit të studentëve nga programi i studimit MSc ADU. Këto të dhëna shërbejnë për treguesit e qëndrueshmërisë së këtij programi të studimeve.<br><br>*Aneksi Nr.29; 2. Studim tregu para hapjes; 3. Studim tregu pas daljes; 2. Studimin e Tregut te Punes per fakultetin dhe departamentin (dok. plotësues)* |
| **Kriteri 3.** Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit garantojnë përftimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që i përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve. | Objektivat e Programit të Studimit të ciklit të dytë, përkatësisht Master i Shkencave të integruara në "Arkitekturë dhe Dizajn Urban" janë të përcaktuara duke i zhvilluar përmes kurrikulës e cila ka përmbajtje të cilat përmbushin kompetencat e studentit.<br><br>Kur analizohet Kurrikula e programit të studimit atëherë objektivat qartësohen duke konsideruar se me këtë program studimi formohen arkitekt dhe dizajner Urban, të cilët do të ushtrojnë kompetenca të arritura nga studimet në rolet e Projektuesit – Dizajnerit, Ekspertit të vlerësimit të punëve inxhinierike, pa e përjashtuar edhe mundësinë e shkollimit të avancuar shkencor në ciklin e tretë.<br><br>Nga takimet e organizuara ne IAL, GVJ konsideron se Studentët e nivelit MSc para diplomimit dhe studentët e diplomuar shfaqin rezultatet e nxënies gjatë studimeve si dhe shkathtësitë e tyre në profesion duke prezantuar dhe zgjedhur edhe probleme të veçanta profesionale nga operativa – praktika.<br><br>*RVB; Aneksi Nr.32.* |
| **Kriteri 4.** Programi i studimit përafrohet me programe studimi të ngjashme të ofruara nga institucione ndërkombëtare me qëllim lehtësimin e transferimit të studimeve apo punësimin e studentëve në të ardhmen në tregun ndërkombëtar. | Kurrikula e programit të studimit MSc ADU përbëhet nga lëndët të cilat konsiderohen të domosdoshme për formimin profesional të Arkitektëve dhe Urbanistëve. Përmbajtja e syllabuseve si dhe përmbajtja e lëndëve janë të kompetencave të fushave të Arkitekturës dhe Urbanizmit të cilat krahasohen me programet e studimeve në vend, rajon si dhe në shumë institucione Evropiane.<br><br>Nga takimet e organizuara në IAL, GVJ konsideron se Studentët e nivelit MSc zotëronin gjuhën Angleze. Kjo konsiderohet si element përmbajtjesor i programit të studimit si dhe mundësia e punësimit të këtij kuadri edhe në nivel ndërkombëtar.<br><br>*RVB; Aneksi Nr.32.* |
| **Kriteri 5.** Programi i studimit hartohet në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe | Programi i studimit MSc ADU është i bazuar në sistemin e Bolonjës. Zhvillimi i kurrikulës, organizimi i peshës së lëndëve sipas ECTS |

| | |
|---|---|
| direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara, mbështetet në përvojën disavjeçare të institucionit dhe praktikat e mira të vendeve evropiane. | përkatësisht ngarkesave të tyre, shpërndarjes në semestra duke qenë uniform janë tregues se ky program studimi MSC ADU është konform standardeve Europiane të Edukimit, nivelit të edukimit si dhe i klasifikuar në profesionet e rregulluara. IAL ka një përvojë mbi 10 vjeçare të zhvillimit të këtij programi të studimit që ndihmon në përmirësimin e vazhdueshëm dhe përsosjen e arritshmërive.<br><br>Universiteti POLIS gjithashtu ka një politikë të mirë të ndërtuar përsa i përket bashkëpunimeve ndërkombëtare të cilat gjithashtu shërbejnë për ngritjen e cilësive të studimeve, sidomos në këtë program të studimit. Marrëveshjet e bashkëpunimit të IAL dëshmojnë për synimin e Universitetit që programet e studimeve, stafi akademik, mobiliteti i studentëve të kontribuojnë në përvetësimin e praktikave më të mira Evropiane.<br><br>*RVB; Aneksi Nr.34, Aneksi 28, Aneksi 19.* |
| **Kriteri 6.** Programi i studimit "Master i shkencave" përfshin aftësimin profesional në praktika profesionale të përputhura me qëllimin dhe objektivat e programit, si dhe në direktiva ndërkombëtare për profesionet e rregulluara. | Aftësimi profesional i studentëve të programit të studimit Master Shkencor i Integruar në Arkitekurë dhe Dizajn Urban është i bazuar në praktikat profesionale të cilat studentët i realizojnë në formë të organizuar institucionale.<br><br>IAl mundëson studentëve për krijimin e praktikave profesionale përmes sistemit mirë të organizuar të brendshëm përmes institutit Co-PLAN pastaj njësive, përkatësisht; qendrës kërkimore në Arkitekturë, qendrës kërkimore në qëndrueshmëri dhe qendrës së burimeve dhe Informacionit.<br><br>Në takimet e GVJ me studentët vërtetuam se praktikat profesionale të studentëve të realizuara sipas objektivave te programit te studimit.<br><br>*RVB; Aneksi Nr.2.* |
| **Kriteri 7.** Në programin e studimit "Master i shkencave", duhet të përfshihen elemente të mësimdhënies, module, lëndë ose i gjithë programi në gjuhë të huaj me qëllim thithjen e studentëve të huaj, rritjen e mobilitetit në kuadër të kërkimit shkencor dhe ndërkombëtarizimin e institucionit. | Brenda lëndëve të kurrikulës së programit të studimit, Master Shkencor i Integruar në Arkitekturë dhe Dizajn Urban, të përfaqësuara me syllabuset e tyre organizohen njësi mësimi të cilat mbulojnë kompetencat e Studentëve, rezultatet e arritshmërisë. IAL angazhon mësimdhënës nga Institucionet ndërkombëtare duke organizuar module dhe lëndë mësimore në gjuhën angleze.<br><br>Gjatë takimeve të GVJ me Mësimdhënësit në programit të studimit si dhe takimet me studentët u vërtetua se në shumë lëndë, mësimi organizohej në gjuhën angleze. Mirëpo jo i gjithë programi organizohet në gjuhë të huaj dhe ky mund të jetë shkaku pse nuk ka ardhje të studentëve nga vendet e tjera.<br><br>Lidhur me ndërkombëtarizimin e IAL, ekzistojnë dëshmi se angazhimi nuk mungon duke realizuar marrëveshje me shumë institucione ndërkombëtare si dhe bashkëpunimi në projekte të ndryshme institucionale.<br><br>*RVB; Aneksi Nr. 19* |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 8.** Për programin studimit "Master i shkencave", institucioni përgatit, ruan dhe arkivon të gjithë dokumentacionin dhe aktivitetin e zhvilluar edhe në gjuhën angleze | IAL ka sistem të organizuar mirë të ruajtjes së dokumentacionit. Gjatë vizitës së GVJ konstatuam se dokumentacioni i studentëve në administratë ruhen dhe përpunohen me shumë kujdes. Faqja elektronike e Universitetit POLIS është kontribuuese e çështjes së azhurnimit dhe ruajtjes së informatave në dy gjuhë. |

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi I.4**<br>**Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni demonstron se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë. | Universiteti POLIS, me VKM nr. 698, datë 11.10.2006, "Për dhënien e lejes për hapjen e shkollës së lartë universitare, jopublike, Universiteti Polis" dhe udhëzimit nr.30 datë 26.09.2007 lidhur me hapjen e procedurave për programet e studimeve në ciklin e parë dhe të dytë, shënon fillimet e punës së IAL. Me VKM nr. 5882/1 të datës 08.11.2012, miratohet ndryshimi i statusit të Institucionit privat të arsimit të lartë "Shkolla e lartë private "Universiteti Polis" nga shkolla e lartë universitare në Universitet. Me vendimin nr. 102 të datës 24.04.2009 miratohen programet e studimeve me ndryshime për cilin e parë dhe të dytë, nga studime të ciklit të parë në studime të Integruara me kohëgjatje 5 vite të ciklit të dytë në të cilin vendim përfshihet programi i studimeve Arkitekturë dhe Dizajn Urban.<br><br>Programi i studimeve MSc i Integruar në Arkitekturë dhe Dizajn Urban është akredituar Urdhrin e MAS, nr. 268, datë 20.05.2016. Ky program zhvillohet në 10 semestra (5 vite studimi) me 300 ECTS, me kohë të plotë.<br><br>Akreditimi periodik IAL Universiteti "POLIS" me vendimin e Bordit të Akreditimit të ASCAL nr. 113 të datës 15.12.2017 është për 6 vite (14.12.2023). Institucioni organizohet me tre fakultete dhe një qendër.<br><br>Nga dokumentacioni i më sipërm vërtetohet e Universiteti POLIS ka një organizim të qëndrueshëm dhe të vazhdueshëm Institucional duke filluar nga themelimi i tij. IAL ka të krijuara organet ekzekutive të sajë si dhe organet kolegjiale përmes së cilave sigurohet një hierarki e marrjes së vendimeve si dhe zbatimin e tyre.<br><br>Në funksionimin e njësive akademike, Fakulteteve departamenteve ndihmojnë Statuti i Universitetit, si dhe rregulloret e brendshme të cilat sigurojnë një mbarëvajtje Institucionale pa zbrastësira.<br><br>IAL ka të angazhuar personelin akademik efektiv dhe Personelin akademik me kontratë. Pjesa e personelit administrativ e cila luan rol të rëndësishëm për funksionimin e Institucionit është e ndërtuar.<br><br>Kapacitetet fizike të IAL për numrin e studentëve janë brenda standardeve. Asetet e infrastrukturës 11.020,00 $m^2$ ndërsa numri i |

| | |
|---|---|
| | studentëve në FAD 890.<br><br>*GVJ vlerëson se IAL ka kapacitete të mjaftueshme për realizimin e programit të studimit Master Shkencor të Integruar në Arkitekturë dhe Dizajn Urban.*<br><br>*RVB; Aneksi Nr.24;Aneksi Nr.42; Aneksi Nr.27; Aneksi Nr.9; Aneksi Nr.42; Aneksi Nr.42.1: Aneksi Nr. 42.2; Aneksi Nr.42.3; Aneksi Nr.42.4; Aneksi Nr. 42.5.* |
| **Kriteri 2.** Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.<br><br>**Kriteri 3.** Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje | Që nga fillimi brenda IAL funksionon Fakulteti i Arkitekturës dhe Dizajnit dhe për programin MSc në Arkitekturë dhe Dizajn Urban, kjo quhet standard i plotësuar përsa i përket përputhshmërisë së fushave institucionale dhe programeve konkurruese e dëshmuar edhe me Statutin e Universitetit POLIS.<br><br>Fushat e përgjithshme të studimit për MSc ADU mund të konsiderohen se janë të përfshira përmes lëndëve me karakter të përgjithshëm shkencor sikur janë Gjeometria Descriptive 1 dhe 2, Ekonomi kantieri, Histori e Arkitekturës, Studio dhe Teori Arkitekture - lende, Studio Finale Arkitekturë 1 dhe 2, Urbanistikë teknike të cilat janë në përputhje edhe me programet tjera përkatësisht me Fakultetet tjera brenda Universitet POLIS.<br><br>Fushat specifike të programit të studimit janë me përmbajtje shumë profesionale të aseteve shkencore të cilat i japin karakterin e veçantë studentit, pas përfundimit të studimeve.<br><br>Programi i studimit MSc ADU përbëhet nga kredite (ECTS), të cilat përcaktojnë peshën e lëndëve. Shpërndarja e lëndëve sipas semestrave (dhjetë semestra) dhe është e ekuilibruar që çdo semestër të ketë 30ECTS.<br><br>Punimi i diplomës së bashku me praktikën profesionale llogariten me peshë ECTS, dhe pas përfundimit të studimeve studenti merr diplomën me titull MSc Arkitekturë dhe Dizajn Urban, me 300 ECTS.<br><br>Departamenti i Arkitekturë dhe Inxhinieri është pjesë përbërëse e Fakultetit të Arkitekturës dhe Dizajnit dhe është përgjegjëse dhe organizimin e aktiviteteve akademike për programin e studimit Msc Arkitekturë dhe Dizajn Urban. Sipas RVB, programet kanë përputhje me listën e profesioneve të Evropës.<br><br>*RVB; Aneksi Nr.2; Aneksi Nr.6; Aneksi Nr.19* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi I.5**<br>**Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e | Universiteti POLIS ka të ndërtuar skemën organizative të sajë duke i |

| | |
|---|---|
| programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre. | përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë e njësive akademike, zyrave brenda institucionit si dhe pjesës së administratës së Universitetit. RVB e përpiluar dëshmon për marrëdhënie të mira ndërmjet administratës së Universitetit, zyrave brenda sajë si dhe personelit akademik pa përjashtuar dhe Studentët të cilët janë pjesëmarrës aktiv.<br><br>*GVJ vlerëson se gjatë takimeve të organizuara në IAL është vërejtur një qëndrueshmëri e institucionit përsa i përket shpërndarjes së përgjegjësisë dhe detyrave të secilit të punësuar në IAL.*<br><br>***RVB; Shënimet në vizitë*** |
| **Kriteri 2.** Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj. | Dëshmitë e ofruara të IAL lidhur me bashkëpunimet institucionale (si dhe nga vizita në institucion, nga GVJ është identifikuar se Universiteti POLIS ka marrëveshje me institucionet vendore dhe ndërkombëtare, ka mobilitetet të studentëve (nga U_POLIS jashtë, ndërsa ka raste edhe të studentëve të ardhur) si dhe mobilitet të mësimdhënësve.<br><br>***Aneksi Nr.32; Aneksi Nr.34; Shënimet në vizitë*** |
| **Kriteri 3.** Për realizmin e programit të studimit "Master i shkencave" institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani, të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj. | IAL ofron dëshmi për lidhjen e 76 marrëveshjeve të bashkëpunimit me Institucionet arsimore nga të cilat rreth 26 janë ndërkombëtare. Gjithashtu lidhja e memorandumeve të bashkëpunimeve me institucione si dhe anëtarësime në rrjete është tregues i krijimit të mundësisë së pjesëmarrjes së stafit akademik në projektet kërkimore shkencore.<br><br>Gjithashtu IAL konfirmon se veprimtaria kërkimore mbështet nga laboratorë ndërkombëtarë she strukturash kërkimore. U_POLIS ka 5 laboratorë për mundësinë e zhvillimit të programeve të studimeve ndër të cilat edhe MSc ADU.<br><br>***RVB, Aneksi Nr.34; Shënimet në vizitë*** |
| **Kriteri 4.** Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programit të studimit që ofron. | U_POLIS për të gjitha programet e studimeve i kushton rëndësi të veçantë zhvillimit të praktikave profesionale, ndërsa për studentët pjesë e programit të studimeve MSc ADU, zhvillimit të praktikave ju krijohen hapësira institucionale të mjaftueshme brenda IAL-së, në laboratorë si dhe në Institucione publike si dhe kompani private, studio të projektimit. Edhe në takimet e zhvilluara të GVJ me studentët u vërtetua se të gjithë studentët ishin të përfshirë në punë praktike, ndërsa kishte studentë të cilit ishin në marrëdhënie pune dhe njëkohësisht studionin.<br><br>Për programin e studimit MSc ADU studentët kanë të përcaktuar se në cilat institucione publike, private ose kompani mund të realizojnë praktikën. IAL ka të realizuar marrëveshje me institucione publike, private dhe kompani vendore për mundësi të realizimit të praktikës.<br><br>Ndërsa brenda U_POLIS është zyra e karrierës dhe Alumni, që mbështesin studentët për realizimin e praktikës.<br><br>***RVB, Shënimet në vizitë*** |
| **Kriteri 5.** Institucioni garanton bashkëpunim me institucione homologe apo institute kërkimore | U_POLIS dëshmon arritjen e marrëveshjeve dhe bashkëpunimeve me Institute të tjera vendore dhe ndërkombëtare, lidhur me realizimin e kërkimeve shkencore, si edhe projekte të përbashkëta në nivel rajonal dhe |

| | |
|---|---|
| shkencore me qëllim realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit dhe studentëve. | ndërkombëtar.<br><br>Universiteti ka të rregulluar infrastrukturën ligjore për realizimin e moblitetit për studentet. Marrëveshjet e IAL gjithashtu konsiderohen kontribuuese për kërkimet shkencore dhe mobilitet.<br><br>*Aneksi Nr.32; Aneksi Nr.34.* |
| **Kriteri 6.** Në mënyrë periodike njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit | Në periudha vjetore IAL ndërton raporte periodike për analizën e punës dhe rezultatet e arritura. Marrëveshjet e arritura janë pjesë e këtyre raporteve. Ndërsa U_POLIS ka të miratuar strategjinë e zhvillimit e cila ka synim ndërkombëtarizimin e Institucionit.<br><br>*Aneksi Nr.17; Aneksi Nr.3; Aneksi Nr.37.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [redacted] | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi I.6**<br>**Institucioni mbështet arritjet në studimet e thelluara dhe të kërkimit shkencor, të cilat promovohen dhe bëhen publike.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni ndjek një politikë mbështetëse për publikimet e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor, veprimtarive kërkimore shkencore të personelit akademik dhe studentëve. | Në takimet e GVJ me mësimdhënësit konstatoi se kishte praktika të mbështetjes institucionale për mësimdhënësit për çështjet e kërkimeve shkencore, përkatësisht publikimit të punimeve shkencore. IAL ka te hartuar edhe raportin e realizimit te aktiviteteve te stafit akademik, përkatësisht kualifikimit të tyre.<br><br>IAL në strategjinë e sajë ka në prioritet kryesor kërkimet shkencore.<br><br>*RVB; Aneksi Nr.3; Aneksi Nr.34; Aneks Nr.43.* |
| **Kriteri 2.** Institucioni ngre një njësi që vlerëson ecurinë e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor. | U_POLIS në skemën e vet organizative ka tre njësi kryesore – Fakultete dhe një Qendër ndërdisiplinore të cilat ndihmojnë, përkrahin dhe motivojnë stafin akademik për të avancuar me gradat shkencore dhe tituj akademike, kjo duke ju krijuar mundësi kuadrit të ri të rekrutuar për studime të shkallës së tretë përkatësisht të doktoratës, pastaj përmes bashkëpunimeve institucionale në projekte të ndryshme, pjesëmarrja në konferenca ndërkombëtare duke u mbështetur financiarisht për pjesëmarrje dhe futjen e punimeve.<br><br>***GVJ konstaton se edhe më tutje IAL duhet të inkurajojë dhe të mbështesë edhe më shumë personelin akademik në aspektin akademik dhe financiar për aktivitetet e kërkimeve shkencore.***<br><br>*RVB; Shënim ne vizite.* |
| **Kriteri 3.** Institucioni ndjek një politikë për promovimin e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor. | IAL siguron mbështetje për fushën e kërkimeve shkencore te personelit akademik, përmes politikave të saja, duke realizuar marrëveshje bashkëpunimi.<br><br>U_POLIS ka të ndërtuar platformën elektronike të Universitetit www.universitetipolis.edu.al në të cilën shfaqen aktivitetet e IAL për |

| | |
|---|---|
| | kërkimet, projektet ndërkombëtare, publikimet e ndryshme në kohë reale. *GVJ vlerëson prezantimin e IAL përmes faqes elektronike.*<br><br>*RVB; Aneksi Nr.34* |
| **Kriteri 4.** Institucioni ndjek një politikë për mbrojtjen e pronësisë intelektuale, si dhe praktikën e mirë në veprimtarinë kërkimore-botuese. | Universiteti POLIS sipas Statutit te vet ka të ndërtuar Këshillin e Etikës, i përbërë nga pesë anëtar të zgjedhur nga Senati Akademik dhe funksionon në bazë të rregullores t ndërtuar brenda IAL.<br><br>Universiteti, përtej kujdesit akademik për mbrojtjen e pronësisë intelektuale aplikon sistemin kundër plagjiaturës Turnitin, i cili përdoret si filtër fundor në publikime dhe në temat e diplomave.<br><br>*RVB; Aneksi Nr.2* |
| **Kriteri 5.** Institucioni inkurajon studentët dhe kërkuesit e rinj për ndërmarrjen e iniciativave vetjake në fushën e kërkimit shkencor | IAL mbështet veprimtarinë shkencore të stafit akademik.<br><br>**GVJ nuk gjeti të kishte praktika të inkurajimit të studentëve për kërkimet shkencore.** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË MASTER I SHKENCAVE/ARTEVE

| **Standardi II.1**<br>**Programi i studimit "Master Shkencor" organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Programi i studimit është i organizuar në lëndë e module, të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). | Personeli akademik dhe ai ndihmës akademik pranë U_POLIS, dhe konkretisht ai i Fakultetit Arkitekturës dhe Dizajnit, janë të angazhuar në mënyrë të vazhdueshme për të garantuar realizimin e objektivave të programit të studimit për Master Shkencor të Integruar në Arkitekturë dhe Dizajn Urban.<br><br>Programi i studimit MSc i integruar në "Arkitekture dhe Dizajn Urban", përbëhet nga lëndë që llogariten me peshë me kreditet ECTS. Programi ofrohet me 300 ECTS, me kohëzgjatje të normale të parashikuar 5 (pesë) vite akademike.<br><br>Klasifikimi i lëndëve mësimore klasifikohet në lëndët; 17% formim bazë i përgjithshëm, 55% karakterizuese, 7% Integruese, 6% me përzgjedhje si dhe teza e diplomës me intership 15%.<br><br>Ngarkesa mësimore e studentit nuk tejkalon 25 orë në javë. (RVB) |

| | |
|---|---|
| | *RVB, Aneksi Nr.5, Aneksi Nr. 14..* |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit "Master i shkencave" synon formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionesh e specialitetesh. | Programi i studimit MSc i integruar në Arkitekturë dhe Dizajn Urban përmbajnë studime të thelluara shkencore dhe këto njohuri studentëve mund të ju shërbejnë për mundësi të vazhdimit të studimeve të cikleve më të larta. Ky program studimi i jep një diversitet studentëve, pasi të i kenë përfunduar studimet.<br><br>*RVB Aneksi Nr.14, Aneksi Nr.14.1.* |
| **Kriteri 3.** Programi i studimit "Master i shkencave" jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës. | Për programin e studimit, MSc i integruar në Arkitekturë dhe Dizajn Urban studentët marrin njohuri të thelluara shkencore me të cilat ata mund të përdorin literaturë jashtëzakonisht të gjerë profesionale, kompetenca për vlerësime të projekteve profesionale si dhe zbatim të njohurive të përgjithshme akademike dhe zgjedhin probleme teknike duke evituar defektet dhe parregullsitë.<br><br>*RVB; Aneksi Nr.14.1.* |
| **Kriteri 4.** Programi i studimit "Master i shkencave" zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale. | Kompetencat e fituara nga programi i studimit janë me shtrirje dhe thellësi të cilat zbatohen në shumë situata të Arkitekturës dhe Dizajnit Urban, duke filluar me mundësinë e udhëheqjes së ekzekutimit të objekteve, hartimin e projekteve profesionale për objektet. Aftësitë e studentëve pas përfundimit të studimeve janë që të ballafaqohen edhe me gjendjen ekzistuese të objekteve,. duke pasur kapacitete edhe për verifikimin e stabilitetit – qëndrueshmërisë së tyre.<br><br>*Aneksi Nr.14.1, Shënime në vizitë* |
| **Kriteri 5.** Programi i studimit "Master i shkencave" përmban të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore. | Programi i studimit përmban të gjitha elementet thelbësore që duhet t'i ketë një Arkitekt dhe një Dizajner Urbanist. Organizimi i tyre, kreditë, syllabuset janë të harmonizuara dhe brenda akteve ligjore.<br><br>*GVJ konstaton se përmbajtja e programit të studimit – kurrikula, lëndët e organizuara, pesha e tyre është e projektuar si model i mirë.*<br><br>*Aneksi Nr.14.1, Shënime në vizitë* |
| **Kriteri 6.** Programi i studimit "Master i shkencave" ka të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët / modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite. | Përbërja e programit të studimeve MSc ADU është sipas i grupeve të lëndëve të klasifikuara sipas:<br><br>Themelimi, formimi i përgjithshëm me lëndët; Gjuha pamore, Histori Arkitekture, Thellim teorik, Metoda të kërkimit shkencor dhe sipërmarrja dhe Biznesi<br><br>Formimi në kulturën arkitektonike ndihmëse me lëndët; Fizika Teknike dhe impianistike, Gjeometri e avancuar, Ekonomi ndërtimi/kantier<br><br>Formimi i thelluar në profesion me lëndët; Studio Arkitektonike të disa niveleve, Teknologji dhe projektim ambiental, Studio dhe Teori Dizajni Urban, Restaurim i trashëgimisë Kulturore, Rigjenerimi Urban, Analiza e morfologjisë dhe tipologjisë në Arkitekturë, Intership, Praktikë profesionale Studio, Dizajn Pejsazhi,<br><br>Në fund të studimeve – Teza – projekti final, punimi i diplomës. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | Kreditet e grumbulluara për çdo kategori janë brenda raporteve të përcaktuar në kuadrin ligjor në fuqi.<br>Pas përfundimit të studimeve, studenti fiton njohuritë për veprimtari profesionale dhe shkencore në:<br>- Projektim<br>- Zbatim<br>- Verifikim<br>- Analiza dhe studime krahasimi, etj.<br>*RVB; Aneksi Nr.14.1.* | | | |
| **Kriteri 7.** Programi i studimit ka të përcaktuar kreditet për realizimin e diplomës dhe aktivitetet kërkimore në kuadër të zhvillimit të saj | Diploma MSc ka peshën e sajë prej 30 ECTS dhe zhvillohet në semestrin e fundit të studimeve. IAL lëshon edhe suplementin si shtojcë të diplomës, me përshkrim të detajuar të njohurive të fituara dhe klasifikimit të kompetencave.<br>*RVB; Aneksi Nr.10* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | X |

| **Standardi II.2**<br>**Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin. | Në takimet me stafin dhe duke u bazuar në dokumentacionin përkatës (*Statutin e Institucionit dhe Rregulloreve te IAL*) u konstatua se Fakulteti përgjegjës, përkatësisht Fakulteti Arkitekture dhe Dizajn, në bashkëveprim me Departamentin i cili merret me organizmin dhe menaxhimin e programit Master i Shkencave i Integruar në Arkitekturë dhe Dizajn Urban janë plotësisht të ndërgjegjshme për përgjegjësitë që kanë për realizmin e programit dhe kjo është treguar në mënyrë kohezive nga vitet e kaluara të veprimtarisë në programin e studimit MSc ADU.<br>IAL ka të themeluara edhe disa nga organe kolegjiale të cilat sigurojnë funksion të mirë të Institucionit sikur janë këshilli i etikës, këshilli i profesorëve, NJSBC, Zyra e këshillimit për studentët dhe Zyra e karrierës.<br>*RVB; Aneksi Nr.5; Aneksi Nr.; Aneksi Nr.7.* |
| **Kriteri 2.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.<br>**Kriteri 3.** Njësia kryesore/bazë | Fakulteti Arkitekturë dhe Dizajn organizohet në njësi bazë dhe ka në përbërjen e tij dy departamente dhe një qendër kërkimore, departamenti Art dhe Dizajn, Departamenti Arkitekturë dhe Inxhinieri si dhe Qendra kërkimore në arkitekturë, inxhinieri dhe Dizajn. |

| | |
|---|---|
| përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik, raportet midis personelit me kohë të plotë, të pjesshme dhe të ftuar.<br><br>**Kriteri 4.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike. | Brenda Departamentit të Arkitekturë dhe Inxhinieri organizohet programi i studimit për Master Shkencor i Integruar në arkitekturë dhe Dizajn Urban.<br><br>Organizimet dhe funksionimet brenda njësive akademike realizohen duke u mbështetur në Statutin e U_POLIS si dhe legjislacionin – Statutitn dhe rregulloret funksionale të IAL-së.<br><br>Kualifikimi i Personelit Akademik në nivel FAD (PAE dhe PAK) është, si më poshtë: |

| Fakulteti Arkitekturë dhe Dizajn | Viti akademik 2020-2021 | |
|---|---|---|
| | PAE | PAK |
| Prof Dr | 2 | .. |
| Prof.Asoc | 0 | .. |
| Dr | 13 | 3 |
| Msc (Dr në proces) | 8 | .. |
| Msc | 15 | 8 |
| Ne total | 38 | 11 |

Departamenti i Arkitekturë dhe Inxhinieri ne FAD përkatësisht në U_POLIS është njësi bazë e zhvillimit të mësimdhënies dhe të punës kërkimore-shkencore të FAD, i cili përfshin fusha kërkimi të Arkitekturës dhe grupon disiplinat mësimore respektive. Në Departamentin e Arkitekturë dhe Dizajn, i cili është përgjegjës për ketë program studimi, në vitin e fundit, rezultojnë të dhënat e kualifikimit të stafit si më poshtë:

| Departamenti i Arkitekturë dhe Inxhinieri | Viti akademik 2019-2020 | | Viti akademik 2020-2021 | | Viti akademik 2021-2022 | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | PAE | PAK | PAE | PAK | PAE | PAK |
| Prof Dr | 0 | 1 | 0 | 1 | 1 | 0 |
| Prof.Assoc | 1 | | 1 | | 0 | 0 |
| Dr | 5 | | 3 | | 8 | 0 |
| Msc (Dr në proces) | 6 | | 5 | | 4 | 0 |
| Msc | 3 | 4 | 3 | 5 | 8 | 4 |
| Ne total | **15** | **5** | **12** | **6** | **21** | **4** |

Departamenti i Arkitekturë dhe Inxhinierisë përmbush detyrimet ligjore duke realizuar punën brenda vetes duke

ligjore duke organizuar dhe mbarëvajtur mësimin, vlerësimet e studentëve, vlerësimet e pedagogëve në mënyrë të vazhdueshme. Shqyrton programet e shpërndarë peshën e punës te secili individ. Edhe raporti i vlerësimit të brendshëm për programin MSc ADU është i hartuar nga stafi i Departamentit, me kryetar të grupit – dekanin e FAD si dhe anëtar të grupit shefin e departamentit.

Departamenti i Arkitekturë dhe Inxhinieri përmbush detyrimet studimit

| | |
|---|---|
| | brenda vetes, analizon kërkesa të ndryshme të stafit akademik, studion nevojat e departamentit. Departamenti i përgjigjet Dekanit të Fakultetit.<br><br>Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit MSc Arkitekturë dhe Dizajn Urban është shtytësi kryesor që çon më tej përmbushjen e Objektivave kryesore dhe te veçanta. Ne çdo fillim viti akademik diskutohen syllabuset e çdo lënde në grupe të ngushta në mënyrë që vazhdimisht të përmirësohen dhe përsosen rezultatet e nxënies.<br><br>Bartësit e lëndëve janë me gradë shkencore së paku Dr, për të cilën kujdeset departamenti. Struktura akademike është e rregulluar në nivel të Universitetit përmes kontratave dhe përcaktimit të detyrave kontraktuale ndërsa për përcjelljen e veprimeve akademike kujdes njësia bazë – Departamenti përkatësisht Fakulteti.<br><br>Raporti i stafit akademik në nivel të FAD është PAE/PAK=38/11 që do të thotë se *rreth* 26.67% janë Personel akademik efektiv ndërsa 77.55% janë personel akademik me kontratë.<br><br>Raporti i stafit akademik në nivel të DAD është PAE/PAK=21/4 që do të thotë *se rreth 84.6 % janë Personel akademik efektiv ndërsa 15.4 % janë personel akademik me kontratë.*<br><br>***RVB; Aneksi Nr.23; Aneksi Nr.24.*** |
| **Kriteri 5.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit angazhon personel akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, projekteve studimore e kërkimore etj. | Departamenti Arkitekturë dhe Inxhinieri i cili merret me organizmin dhe menaxhimin e programit Master i Shkencave i Integruar në Arkitekturë dhe Dizajn Urban, është plotësisht i ndërgjegjshëm për përgjegjësitë dhe detyrimet që kanë për realizmin e programit, duke respektuar kriteret ligjore për nivelin e studimeve Master Shkencorë dhe kjo është treguar në mënyrë kohezive në vitet paraprake të veprimtarisë lidhur me programin e studimit.<br><br>Gjatë vizitës së GVJ në takimet me studentët konstatuam se praktika mësimore udhëhiqet nga personeli akademik i departamentit. Gjithashtu edhe ushtrimet laboratorike në ambientet e Universitetit udhëhiqen nga stafi akademik ndihmës. |
| **Kriteri 6.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. | Rektori i U_POLIS emërton koordinatorët e programeve të studimeve. Secili program i studimit ka një koordinator. Departamenti i Arkitekturë dhe Inxhinieri organizon dhe zhvillon programin e studimit me ndihmën e koordinatorit të programit të studimit.<br><br>Koordinatori i programit të studimit jep llogari Departamentit dhe Dekanit të Fakultetit lidhur me shqetësimet e studentëve për realizimin e programit të studimit.<br><br>***RVB, Aneksi Nr. 36.*** |
| **Kriteri 7.** Koordinatori i programit raporton në mënyrë periodike te drejtuesi i njësisë përgjegjëse dhe dokumenton çdo | Koordinatori i emëruar për programin e studimeve MSc FAD, organizon takime periodike me stafin e programeve ndërsa vet koordinatori është pjesë e Departamentit. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| informacion që lidhet me programin e studimit | Këto takime organizohen edhe në bazë mujore në nivel të Fakultetit të Arkitekturës dhe Dizajnit.<br><br>*RVB.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi II.3**<br>**Programi i studimit Master Shkencor është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit. | Departamenti i Arkitekturës dhe Inxhinieri së bashku me Fakultetin e Arkitekturës dhe Dizajnit janë përgjegjëse për zhvillimin e programit të studimit Master Shkencor i Integruar në Arkitekturë dhe Dizajn Urban.<br><br>GVJ konstaton se materialet e ofruara, takimet me studentët dhe pedagogët dëshmojnë për angazhim maksimal të Departamentit për zhvillimin e programit të studimit duke i përcjellë me përkushtim suksesin e studentëve, duke organizuar kurse shtesë për studentët me qëllim avancimin e kompetencave të tyre.<br><br>Për funksionimin e programit të studimit departamenti bazohet në respektimin e akteve ligjore dhe rregulloreve të Universitetit.<br><br>Në departament ishin të depozituara plani mësimor i programit të studimit, syllabuset e lëndëve, Rregullorja e programit të studimit dhe Lista e personelit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme, të aktivizuar në vite në mësimdhënie në këtë program studimi. |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit organizohet në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi<br><br>**Kriteri 3.** Programi i studimit organizohet në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra. | Ky program studimi i ciklit të dytë është program i Integruar në pesë vite studimi (10 semestra) i cili jep formim më të gjerë në fushën e Arkitekturës dhe Dizajnit. Programi është i organizuar në lëndë dhe i vlerësuar në kredite, sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Programi është zhvilluar në përputhje me programin e licencuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.<br><br>Lëndët e programit të studimit përbëjnë kurrikulën, me shtrirje të projektuar të fushave të përgjithshme, karakteristike dhe profesionale. Programi i studimit përmban praktikën profesionale si dhe punimin e diplomës e cila punohet në semestrin e dhjetë.<br><br>Programi i studimit në MSc ADU, me nga 60 ECTS për çdo vit akademik, plotëson kriteret e organizimit dhe grumbullimit të krediteve brenda kornizës ligjore, e cila parashikon studime me kohë të plotë, dhe një minimum prej 300 kredite ECTS.<br><br>*RVB; Aneksi Nr. 7; Aneksi 14.1.* |
| **Kriteri 4.** Programi i studimit përmban planin mësimor, ku | Kurrikula përbëhet nga të gjitha kategoritë e lëndëve të përgjithshme, profesionale, Integruese, plotësuese dhe përmbyllëse. Çdo lëndë ndahet në |

| | |
|---|---|
| përfshihet informacion i nevojshëm për ngarkesën mësimore, orët në auditor/ jashtë auditorit, frekuentimin/ ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj. | aktivitete formuese si: Leksione/ Seminare/ushtrime /laboratorë/ detyra kursi/praktika mësimore Studio projektimi - Arkitekturë.<br><br>Konkretisht për vlerësimin e arritjeve të studentëve, sipas syllabuseve të dorëzuara nga IAL rezulton:<br><br>- 10 % Frekuentimi<br>- 10% Aktivizimi<br>- 10 % Blloku i Punës<br>- 10 % ushtrimi 1<br>- 15% ushtrimi 2<br>- 20 % ushtrimi 3<br>- 15 % Paraqitja<br>- 5% cilësia e prezantimit Final<br>- 5 % Ese/Detyra<br><br>Sipas rregulloreve të brendshme të IAL dhe bazuar në specifikat e veçanta të programit të studimit elementet e aktiviteteve akademike janë (RVB):<br><br>- Leksione 8-12 orë në auditor 13-17 orë punë e pavarur e studentit<br>- Seminare 6-8 orë në auditor 17-19 orë punë e pavarur e studentit<br>- Laboratorë/studio 12-18 orë në auditor 7-13 orë punë e pavarur e studentit<br>- Praktikë profesionale 5 orë në auditor 20-25 orë punë e pavarur e studentit<br>- Teza dhe projekt diploma 5 orë në auditor dhe 20 orë punë e pavarur e studentit.<br><br>Syllabuset përcaktojnë shpërndarjen e aktiviteteve mësimore, frekuentimin mënyrën e vlerësimit të studentit për lëndë, vlerësimet gjatë vijueshmërisë.<br><br>*RVB; Aneksi Nr.14.1; Aneksi Nr.19* |
| **Kriteri 5.** Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. | Gjatë takimit me studentët, GVJ hasi në raste të transferime të studentëve nga institucionet tjera në U_POLIS. Procesi i ekuivalentimit ishte realizuar nga vetë IAL duke u mbështetur në programin e studimit të akredituar.<br><br>Programi i studimit është lehtësisht i mundur të krahasohet me programe nga institucionet vendore dhe ndërkombëtare për fushat e inxhinierisë së ndërtimit. Këtë e mundësojnë lëndët brenda kurrikulës, pesha e tyre si dhe përmbajtja.<br><br>*RVB; Aneksi Nr.14; Aneksi Nr.14.1, Aneksi Nr.2.* |
| **Kriteri 6.** Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminaret apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara. | Forma standarde e syllabusit për lëndët e programit të studimit në MSc ADU është përmbajtjesore dhe ka brenda vetes planin e punës përgjatë gjithë së zhvillimit, mësimi javor – përshkrimi, sasia e orëve në auditor, në ushtrime, laboratorë frekuenca etj.<br><br>Syllabuset e lëndëve bëhen publike në faqen elektronike të Fakultetit, platforma PITAGORA. Syllabuset ju prezantohen studentëve në fillim të semestrit.<br><br>Për secilën lëndë mësimore të programit të studimit, syllabuset ju prezantohen studentëve në fillim të semestrave përkatëse. Nga vizita në |

| | |
|---|---|
| | institucion u verifikuan të gjitha syllabuset e lëndëve për programin e studimit dhe konstatojmë se janë në përputhje me standardet.<br><br>*RVB; Aneksi Nr.19.* |
| **Kriteri 7.** Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht | GVJ konstaton se programi i studimit programi i studimit Msc ADU ka ndryshime minimale nga akreditimi i fundit vlerësuar nga dokumentacioni i ofruar nga IAL.<br><br>*GVJ rekomandon institucionin që të planifikojë ndryshime për të ardhmen, duke pas parasysh kërkesat e mundura nga tregu i punës si dhe analizat e ALUMNI.*<br><br>*RVB, Aneksi Nr.52.1* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi II.4**<br>**Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Ngarkesa e programit të studimit "Master i Shkencave" është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi. | Shpërndarja e ngarkesës së mësimdhënies është në norma akademike dhe i shpërndarë përafërsisht në mënyrë të njëtrajtshme.<br><br>Ngarkesa e studentëve në semestra është e ekuilibruar. Gjykuar sipas takimeve me studentët, ngarkesa mësimore në bazë javore për studentët është rreth 25 orë.<br><br>Gjithashtu edhe ngarkesa mësimore për stafin akademik është në kuadër të ligjeve vendore të lëshuara nga Ministria për Arsim Sport dhe Rini. GVJ konstaton se stafi akademik efektiv i IAL-së është i angazhuar në kohë pune të plotë dhe përveç mësimdhënies ata janë të angazhuar në shërbimet organizative, administrative të Universitetit.<br><br>Megjithëse për IAL jopublike nuk ka limite ligjore, ngarkesa mësimore e personelit akademik konsiderohet relativisht e lartë duke pasur parasysh se ka ndër ta me ngarkesë vjetore prej 600-720 orës. Gjithashtu, edhe numri i moduleve në të cilat angazhohet stafi është relativisht i lartë dhe referuar Aneksit Nr. 25 mbërrin në disa raste në 10-19 module.<br><br>***GVJ, duke gjykuar që ngarkesa e lartë ndikon në cilësinë e mësimdhënies, rekomandon reduktimin e numrit të moduleve dhe disiplinave në të cilat angazhohet personeli akademik, si edhe reduktimin e ngarkesës vjetore në auditor.***<br><br>Duke u referuar në Udhëzimin 29/2018 të MASR, por edhe në eksperiencën ndërkombëtare, ngarkesa të tilla në mësimdhënie konsiderohen të larta dhe mund të ndikojnë në cilësinë e mësimdhënies.<br><br>*Aneksi Nr.25* |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 2.** Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve. | Thellësia e studimeve, përkatësisht përmbajtja e kurrikulës me lëndët e sajë përmbajtjesore krijon mundësi të nxënies së njohurive Arkitekturore të thelluara dhe mundësitë e vazhdimit të studimeve të ciklit të tretë dhe studimeve tjera të avancuara shkencore dhe profesionale.<br><br>*Aneksi Nr.14* |
| **Kriteri 3.** Lëndët/ modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor. | **A) Në programin e studimit Master Shkencore e Integruar ne Arkitekture dhe Dizajn Urban,** kurrikula përmban:<br><br>Në vitin e parë: Analizë territori dhe Vendbanimi I, Histori Arkitekture dhe qyteti I, Studio dhe Teori Arkitekture 1A, Gjemoetri Descriptive 1, Matematikë, Gjeometri Deskriptive 2, Gjuha Pamore, Analizë territori dhe vendbanimi II, Studio dhe Teori Arkitekturore 1B dhe Histori Arkitekture dhe Qyteti II.<br><br>Në vitin e dytë: EKSFilosofi Hapësire, Studio dhe Teori Arkitekture 2A, CAAD I, Materiale Ndërtimi dhe Teknika Konstruktive, Teknologji Arkitekture 1, Shkenca Konstruksioni 1, WSHP Ndërkombëtare – Stage for the City, WSHP Ndërkombëtare – Invisible Landscape, Topografi, Ligji dhe Legjislacioni Urban, Rilevim Arkitekture, CAAD II, Studio dhe Teori Arkitekture 2B, Teknologji Arkitekture 2 dhe Shkenca Konstruksioni 2.<br><br>Në vitin e tretë: CAAD III, Studio Planifikimi Urban, Fizikë Teknike + Impianistikë, Ekonomi kantier ndërtimi, Studio dhe Teori Arkitekture 3A, Analizë e Tipologjisë dhe Morfologjisë Arkitekturë, Studio Dizajn Urban Ambiental, WSHP Ndërkombëtar – The caring city, Urbanistikë Teknike, Rrjete Elektrike, Rrjetë Teknologjike – Furnizim me ujë, Studio dhe Teori Arkitekture 3B dhe Studio dhe Teori Dizajni Urban.<br><br>Në vitin e katërt: Restaurimi i Trashëgimisë Kulturore, Dizajn Grafik dhe Industrial, Advanced Studio in Architecture and IT, Dizajn Peizazhi, Studio dhe Teori Arkitekture 4A, WSHP Ndërkombëtare – Back to Nature, Studio dhe Arkitekturë 4B, Projekt Zbatimi, Studio dhe Teori Arkitekture Interieri, Parafabrikim Dixhital dhe Prototipizim, Rigjenerim Urban dhe Projekte me Kompjuter.<br><br>Në vitin e pestë: Metodat të kërkimit Shkencor, Studio Profesionale në Arkitekturë, Sipërmarrja dhe Biznesi, Studio Finale Arkitekturë 5, Thellim Teorik, WSHP Ndërkombëtare – OASI, Studio Finale Arkitekturë , Intershipi profesional dhe Teza dhe Projekt Diploma.<br><br>***Rekomandohet rritja e fondit të lëndëve me zgjedhje.***<br><br>Kjo shpërndarje e lëndëve për programin e studimit MSc, për dy profilet është funksionale. *Rekomandohet që IAL të realizojë ndryshime të vogla dhe sidomos ngarkesa në semestra të jetë e ekuilibruar në 30 ECTS.*<br><br>*RVB; Aneksi Nr.14.1* |
| **Kriteri 4.** Struktura e programit të studimit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti | Referuar praktikave të suksesshme ndërkombëtare në programet e integruara të studimeve në fushën e arkitekturës, vlerësojmë se programi |

| | |
|---|---|
| teori-praktikë është në përputhje me profilin e programit master dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. | është i mirë-strukturuar si në formë ashtu edhe në përmbajtje.<br><br>Raporti teori praktikë vlerësohet në nivelin e përshtatshëm për këtë program studimi duke pasur parasysh se përtej internshipit, në çdo semestër zhvillohen studiot e projektimit që formojnë studentin nga ana praktike në aktivitetin projektues.<br><br>Intershipi profesional ka peshë prej 6 ECTS që përbën 2% e peshës së studimit që për programin e studimit Master Shkencor i Integruar në Arkitekturë dhe Dizajn Urban, konsiderohet normë e pranuar. Me 6 ECTS duke llogaritur sipas normave Evropiane 25 orë pune e studentit për një ECTS praktikë profesionale studenti duhet të bëjë 150 orë pune, ose zbërthyer në ditë 18.25 ditë pune.<br><br>Ndërsa brenda lëndëve organizohen edhe punë laboratorike si dhe vizita me karakter profesional gjë që e rritë efektin e praktikës.<br><br>***RVB; Aneksi Nr.14.1*** |
| **Kriteri 5.** Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve. | GVJ konsideron se ky program i studimit është i projektuar sipas mundësisë së ofertës të të diplomuarave në tregun e punës. Pjesa praktike në kurrikulë është me hapësirë të mjaftueshme. Rritja e lëndëve me zgjedhje do të rrisë diversitetin e veprimtarive formuese të studentit. Kreditet ECTS janë të plotëpjesëtueshme me 3 dhe kjo gjë i ndihmon studentët për mobilitet dhe ekuivalentim të lëndëve duke pas mundësi të përputhjeve – përshtatjeve. Në bazë të prezantimeve në takimet me GVJ të punësuarit e këtyre profileve janë në shkallë të lartë. |
| **Kriteri 6.** Syllabuset (programet e lëndëve/ moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit. | Në takimet e GVJ në IAL ndryshimet në syllabuese nga akreditimi i fundit janë të vogla dhe të pa përfillshme.<br><br>***RVB; Aneksi Nr.52.1*** |
| **Kriteri 7.** Përmbajtja e programit të studimit garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programin e studimit të ciklit të dytë. | Përmbajtjet e programit të studimit sigurojnë mjaftueshëm përfitimin e aftësive profesionale dhe shkencore.<br><br>Kompetenca të diversiteteve të veprimtarive rezultojnë shumë të gjera. |
| **Kriteri 8.** Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës. | Kërkesat e tregut të punës duhet të jenë determinuese në përshtatjen e programit të studimit. IAL nuk ofroi ndonjë evidencë bindëse për vlerat kthyese nga tregu i punës, për ndonjë ndryshim ose plotësim të programit të studimit.<br><br>Në takimet me studentët *GVJ vlerëson njohuritë e fituara të të diplomuarve si dhe ofertën e tyre në tregun e punës.* |
| **Kriteri 9.** Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve | *GVJ vlerëson FAD përkatësisht U_POLIS për nivelin e arritjes së kontratave dhe marrëveshjeve me institucioneve kombëtare dhe ndërkombëtare* duke intensifikuar kontaktet me tregun e punës për fushat e arkitekturës dhe të marrin nektarin e tyre për përshtatjen e lëndëve sipas kërkesave të tyre. |

| | |
|---|---|
| nga tregu i punës. | |
| **Kriteri 10.** Kombinimi i veprimtarive të formimit teorik dhe shkencor, mundësojnë njohuri të avancuara për studime, kërkime, analiza dhe vijim të aktivitetit shkencor në ciklin e tretë të studimeve | Programi i studimit ka përmbajtje që siguron njohuri të mjaftueshme të formimit teorik dhe shkencor për studentin.<br><br>Niveli i lëndëve teorike në përmbajtje të kurrikulës siguron që një student mund të merret me aktivitetet shkencore dhe të vazhdojë studimet në ciklin e tretë. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi II.5**<br>**Personeli akademik dhe ndihmës akademik që mbulon programin e studimit përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit "Master i shkencave"** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.<br><br>**Kriteri 2.** Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit "Master i shkencave", ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit. | Rekrutimi i Personelit Akademik kryhet sipas proceduarve ligjore në përputhje me Statutin dhe rregulloret e Institucionit. Stafi akademik është i specializuar në fushat përkatëse të shkencës për të dhënë leksionet dhe seminaret e programit, që janë specifike për këtë program.<br><br>Stafi Administrativ, dhe Menaxherial i Fakultetit, përkatësisht Universitetit angazhohen në maksimum që Studentëve të ju ofrohen shërbime cilësore, në kuptimin e shpejtësisë, saktësisë dhe sigurisë. Të gjitha këto shërbime janë paketë shërbimi që prodhojnë cilësi duke numëruar infrastrukturën e Fakultetit, shërbimet e informacioneve, kontratat, Bibliotekën etj..<br><br>Nga evidencat e ofruara nga IAL vërtetohet se bartësit e lëndëve janë me grada shkencore së paku Dr, [ndërsa ka disa edhe me kualifikimin MSc (Dr ne proces), apo Msc - por këto asistojnë profesorët me tituj/grada]. ***GVJ nga të gjeturat vlerëson përpjekjen e IAL për të angazhuar staf të kualifikuar, por sheh të nevojshme përmbushjen e kërkesave të Ligjit 80/2015 (neni 59, pika 6). Për këtë qëllim GVJ rekomandon mbulimin e plotë të ngarkesës mësimore në vitin e katërt dhe të pestë me personel akademik që ka të paktën gradën shkencore Doktor.***<br><br>Personeli akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme në 3 vitet e fundit duke u mbështetur në dokumentet e ofruara nga IAL për Departamentin e Arkitekturës dhe Inxhinierisë përgjegjëse për programin e studimeve Master Shkencor i Integruar për Arkitekturë dhe Dizajn Urban, rezulton me të dhënat si më poshtë: |

| Departamenti i Arkitekturë dhe Inxhinieri | Viti akademik 2019-2020 | | Viti akademik 2020-2021 | | Viti akademik 2021-2022 | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | PAE | PAK | PAE | PAK | PAE | PAK |
| Prof Dr | 0 | 1 | 0 | 1 | 1 | 0 |
| Prof.Assoc | 1 | | 1 | | 0 | 0 |
| Dr | 5 | | 3 | | 8 | 0 |
| Msc (Dr në proces) | 6 | | 5 | | 4 | 0 |
| Msc | 3 | 4 | 3 | 5 | 8 | 4 |
| Ne total | **15** | **5** | **12** | **6** | **21** | **4** |

Bazuar në planin mësimor të miratuar në fillim të çdo viti akademik, bëhet shpërndarja e ngarkesës.

Raporti PAE/PAK për programin e studimit është:

2016-2017: 30 PAE / 6 PAK (83%)

2017-2018: 31 PAE / 9 PAK (77.5%)

2018-2019: 37 PAE / 8 PAK (82.2 %)

2019-2020: 36 PAE / 7 PAK (83.7 %)

2020-2021: 36 PAE / 10 PAK (78.2 %)

2021-2022: 50 PAE / 10 PAK (83.3 %)

Vihet re që numri i personelit akademik të angazhuar për programin e studimit ka ardhur vazhdimisht në rritje, sidomos në vitin akademik 2021-2022. Ndërkohë, raporti PAE/PAK luhatet mes 3.4-5.1 / 1 duke garantuar gjithmonë mbi 75% të personelit akademik efektiv.

Duke vënë re se personelit akademik me kohë të plotë ka mbingarkesë akademike (shih Standardi II.4, kriteri1) dhe numri i studentëve është në rritje, ***GVJ rekomandon shtimin e personelit akademik me kohë të plotë për këtë program studimi.***
IAL nxitë bashkëpunimin dhe ndërveprimin mes anëtarëve të njësive që u vërtetua edhe nga takimet e GVJ me pedagogët.
*RVB, Aneksi Nr.25, Aneksi Nr.23, Tabela Përmbledhëse - Tabela 6*

| | |
|---|---|
| **Kriteri 3.** Fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik, që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij. | Pjesa dërmuese e stafit akademik PAE dhe PAK të programit të studimit MSc në Arkitekturë dhe Dizajn Urban janë të fushave përkatëse Arkitektonike si dhe Inxhinierike me specialitete të kompetencave të larta dhe që i shkon në favor programit të studimit, ndërsa lëndët individuale të tyre mbulohen me profesionalizëm të nivelit të lartë. *RVB, Aneksi Nr.25; Aneksi Nr.23* |
| **Kriteri 4.** Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për | IAL ka të angazhuar personel të kualifikuar dhe me njohuri në fushat e Arkitekturës, i cili është përgjegjës edhe për zhvillimin e praktikës profesionale. IAL ka marrëveshje bashkëpunimi me institucionet vendore për realizimin e praktikës profesionale. |

| | |
|---|---|
| instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit. | *RVB; Aneksi Nr.32* |
| **Kriteri 5.** Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmësmësimorshkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit | GVJ gjatë vizitës në ambientet e Universitetit, përkatësisht laboratorëve të cilat shfrytëzohen nga studentët udhëheqen nga stafi ndihmës i universitetit i cili merrej ekskluzivisht me punën e laboratorëve ndërsa mësimdhënësi ishte staf ndërkombëtar.<br><br>Mirëmbajtja e pajisjeve laboratorike në nivel të kënaqshëm.<br><br>*RVB* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | X | |

| **Standardi II.6**<br>**Institucioni i arsimit të lartë inkurajon përfshirjen e studentëve dhe partnerëve në përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës. | U_POLIS ka një listë subjektesh me të cilën dëshmohen qëllimet e marrëveshjeve të arritura ose mëtojnë të arrihen. Asnjë nga ato marrëveshje nuk ka të specifikuar ndonjë aktivitet lidhur me "Kthimin e informacionit nga tregu i punës" për eventualisht përmirësimin e programeve të studimit. ***GVJ rekomandon IAL që të fusë në funksion mundësinë e kthimit të informatës nga tregu i punës për përditësimin e programit të studimit.***<br><br>*RVB; Aneksi Nr.34* |
| **Kriteri 2.** Institucioni inkurajon dhe përfshin në diskutime në kuadër të përmirësimit të programit të studimit edhe studentët dhe strukturat e tyre. Propozimet diskutohen dhe reflektohen, nëse ato janë në funksion të përmirësimit të programit të studimit. | Gjatë takimit me studentët u vu re se komunikimi me ta është i vazhdueshëm përmes personelit akademik dhe strukturave drejtuese të universitetit. Studentët marrin pjesë përmes përfaqësuesve të tyre në Senatin Akademik si dhe në struktura të tjera ku mund të shprehin në mënyrë formale mendimet e tyre. Për sa i përket diskutimeve dhe shkëmbimit të mendimeve në lidhje me programin e studimit apo aspekte të jetës studentore, u vu re që komunikimi është i përditshëm, spontan dhe intensiv. |
| **Kriteri 3.** Institucioni mban kontakte dhe konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe merr prej tyre propozime për përmirësimin e programit të studimit. | U_POLIS ka të ndërtuar dhe ka në funksion ALUMNI përmes së cilës zyre ruhen kontaktet me studentët e diplomuar. Sipas Raportit të Vlerësimit të Brendshëm, studentët e diplomuar japin kontribut duke shkëmbyer mendime në kuadër të përmirësimit të përmbajtjes së lëndëve të programit të studimit. Alumni ka rrjetin e krijuar të studentëve të diplomuar.<br><br>*RVB; Takimi me studentet ne IAL* |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 4.** Në bashkëpunim me institucione kërkimore e shkencore, publike e private, njësitë e pushtetit vendor etj., institucioni përditëson, përshtat dhe riorganizon programe të posaçme me fushë specifike studimi e kërkimi | Nuk mungon bashkëpunimi i U_POLIS me institucione kërkimore dhe shkencore.<br><br>IAL organizon edhe trajnime shtese për stafin e vet si dhe për studentët.<br><br>*RVB; Aneksi Nr.17* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi II.7**<br>**Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit. | Përmbajtja e programit të studimit Master Shkencor i Integruar në Arkitekturë dhe Dizajn Urban përkatësisht kurrikula me lëndët e sajë dhe syllabuset e tyre qartësojnë prioritetet dhe objektivat e studimit. Ato janë me përmbajtje të thelluar shkencore, që si produkt i programit të studimit do të krijohen profesionist të cilëve ju jepet mundësia për vazhdim të studimeve të mëtejme në ciklin e tretë si dhe mundësi e zhvillimit të veprimtarive profesionale në tregun e punës.<br><br>Objektivat e programit të studimit përputhen me objektivat e institucionit.<br><br>Objektivat e Programit te studimit MSc Arkitekturë dhe Dizajn Urban janë të përcaktuara duke u mbështetur në objektivat e përgjithshme të Institucionit dhe deklarojnë: Të përgatisë specialistë të lartë, lider në fushën e arkitekturës, në përputhje me kërkesat dhe nevojat e shoqërisë në ndryshim.<br><br>*RVB; Aneksi Nr.19; Aneksi Nr.7; Aneksi Nr.14.1* |
| **Kriteri 2.** Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit. | Departamenti i Arkitekturë dhe Inxhinieri menaxhon programin e studimit në Master Shkencor i Integruar në Arkitekturë dhe Dizajn Urban.<br><br>Departamenti kujdeset për stafin akademik, për ngarkesën e tyre në mësimdhënie si dhe në punët administrative të IAL. Shkalla e lirisë akademike të stafit të U_POLIS është e pa cenuar, ata mund të zhvillojnë kërkime shkencore në mënyrë të pa penguar dhe mund të kërkojnë edhe ndihmën institucionale që në fakt edhe ju ofrohet. GVJ gjatë takimit me stafin akademik konstatoj se shkalla lirisë të stadit akademik është e pa cenuar dhe se IAL i motivon që ata të jenë edhe më shumë të angazhuar për fushat e kërkimeve, ndërsa asnjë ndërhyrje në proceset e mësimdhënies nuk është identifikuar.<br><br>*RVB* |
| **Kriteri 3.** Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete | Ky program i studimit është shumë dinamik dhe me peshë shkencore dhe hulumtuese, prandaj studentët janë të motivuar nga vet natyra e problemeve që ju parashtrohen duke u sfiduar me detyra projektuese, analiza të rasteve studimore për raste shumë specifike. |

| | |
|---|---|
| kërkimore. | IAL ka edhe buletinin e vet ku mund të publikohen punime të punuara nga studentët si dhe stafi akademik i U_POLIS.<br><br>*RVB* |
| **Kriteri 4.** Programi i studimit fokusohet në hartimin dhe zbatimin e politikave studimore e shkencore rajonale dhe kombëtare. | Programi i studimit Master Shkencor i Integruar në Arkitekturë dhe Dizajn Urban ka një standard i cili ka përputhshmëri me konceptet e formimit të Arkitektëve Dizajner. Ky identet mund të gjendet në përmbajtje edhe me programet e studimeve në institucionet arsimore në vend, rajon dhe më gjerë. |
| **Kriteri 5.** Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme | GVJ gjatë takimit me stafin akademik vërtetoj se sigurohet mbështetje institucionale për kërkimet shkencore, qofshin mbështetje akademike ashtu edhe financiare. |

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi II.8 Institucioni i arsimit të lartë nëpërmjet programit të studimit garanton njohuri të thelluara, studime dhe kërkim shkencor, ndërkombëtarizim të studimeve dhe kërkimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor. | Grupet lëndore janë me përmbajtje shkencore të thelluar. Me grupin e lëndëve të karakterit profesional mund të realizohen hulumtime shkencore.<br><br>GVJ konstaton se ky program studimi është i zhvilluar në më gjatë se një dekadë nga e kaluara dhe laboratorët ekzistuese edhe mund të konsiderohen me mundësi që t'ju ofrojnë stafit akademik dhe studentëve hulumtime shkencore të avancuara mirë Universiteti duke qenë i profiluar me kryesisht shkencat inxhinierike dhe arkitekturore atëherë rritja e kapaciteteve infrastrukturore të Laboratorëve të mendohet si kërkesë e domosdoshme e kohës.<br><br>U_POLIS ka një reputacion shumë të mirë përsa i përket marrëveshjeve institucionale. Janë shumë universitete me të cilat IAL ka marrëveshje bashkëpunimi.<br><br>*RVB; Aneksi Nr.34* |
| **Kriteri 2.** Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave. | U_POLIS përkatësisht FAD, Departamenti i Arkitekturë dhe Inxhinieri nga GVJ vërtetohet se janë mjaft aktive lidhur me realizimin e studimeve përkatësisht analizave sistematike brenda institucionit, për të fituar pasqyra sa më të qarta të arritshmërive të IAL përkatësisht edhe të studentëve.<br><br>Në strategjinë e hartuar të Universitetit për periudhën 2021-2026, janë të përfshira mënyrat e zhvillimit të kërkimit shkencor duke insistuar në përmbushjen e misionit të tij.<br><br>Në bazë të evidencave të ofruara nga UPOLIS, aktivitetet institucionale lidhur me mundësinë e krijimit të kushteve për hulumtime janë në nivel të |

| | |
|---|---|
| | kënaqshëm. Në të gjitha aktivitetet– marrëveshjet e arritura janë të përfshirë personeli akademik.<br><br>IAL kujdeset që në nivel të departamenteve të hartohet plani vjetor i kërkimeve shkencore i cili miratohet nga Dekani i Fakultetit.<br><br>*RVB; Aneksi Nr.3; Aneksi Nr.45* |
| **Kriteri 3.** Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave | U_POLIS ka të radhitura mjaft aktivitete lidhur me kërkimet shkencore përmes projekteve të ndryshme si dhe marrëveshjeve institucionale të realizuara. Është pjesë përbërëse e shumë projekteve ndërkombëtare.<br><br>Ka të organizuara workshope, trajnime dhe aktivitete tjera me qëllim arritjen e objektivave të saja. GVJ nuk gjeti dëshmi për organizimin e ndonjë konference që lidhet me studimet e Inxhinierisë së Ndërtimit. *RVB* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

## III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

| **Standardi III.1**<br>**Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve moduleve. | U_POLIS duke organizuar programe të studimit kryesisht të fushave të arkitekturë, Inxhinieri etj ka koncepte të qartësuara filozofike për formime teorike me atë kërkimore dhe me zhvillimin e praktikave profesionale. Nga organograma e IAL me përbërjen e njësive akademike bazë vërehen fushat e studimeve si dhe profilimin Institucional të IAL-së, dhe kjo e ndihmon fokusin e veprimit të çështjes duke krijuar politika inovative duke zbatuar metoda të avancuara të mësimdhënies si dhe vlerësime të studentëve dhe Stafit akademik me peshë dhe seriozitet.<br><br>Gjithashtu U_POLIS organizon trajnime të stafit akademik. |
| **Kriteri 2.** Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik. | Në strukturën (organigramën) e IAL janë të ndërtuara dhe funksionale zyra të cilat kanë detyrën e përcaktuar për përcjelljen e mbarëvajtjes së mësimit.<br><br>NJSBC pjesë e U_POLIS, është monitoruese dhe indikator për rritjen e cilësisë akademike e cila zyre punon sipas rregullores institucionale të miratuar. Brenda institucionit bëhen vlerësime të mësimdhënësve nga studentët dhe në varësi të rezultateve IAL reagon. Përgjegjës për zhvillimin e programit të studimit është Departamenti i Arkitekturë dhe Inxhinieri.<br><br>*RVB; Aneksi Nr.3; Aneksi Nr.8; Aneksi Nr.40; Aneksi Nr.41* |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 3.** Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve. | Në takimet e GVJ me studentët dhe me mësimdhënësit vlerësuam se pjesa dërmuese e Studentëve bën vlerësimin e lëndës dhe mësimdhënësit sipas kritereve të përcaktuara nga Institucioni. Këto vlerësime janë autonome dhe të paanshme. Ato kontribuojnë në ngritjen e cilësisë së veprimtarive akademike.<br><br>*RVB; Aneksi Nr.3; Aneksi Nr.8; Aneksi Nr.41.* |
| **Kriteri 4.** Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie, bëjnë publike rezultatet e vlerësimit. | Rezultatet e vlerësimeve të studentëve për profesorët janë të organizuara në mënyrën institucionale duke i analizuar të njëjtat nga Dekani i Fakultetit deri te Rektori i U_POLIS për të marrë masa konkrete.<br><br>*RVB; Aneksi Nr.37.* |
| **Kriteri 5.** Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembujt të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies | FAD këto analiza nga vlerësimet e studentëve për pedagogët i shfrytëzon më së miri për promovimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies dhe normave akademike të pedagogëve.<br><br>*RVB; Aneksi Nr.37.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi III.2 Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminaret, punët laboratorike, detyra kursi, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni. | Procesi i zhvillimit të programit të studimit Master Shkencor i Interguar në Arkitekturë dhe Dizajn Urban nga U_POLIS organizohet me aktivitete akademike nga të gjithë pjesëmarrësit, mësimdhënësit e rregullt, mësimdhënësit e angazhuar dhe ndihmës, administrata si dhe organet kolegjiale të IAL në bashkëpunim me menaxhmentin.<br><br>Sipas rregulloreve të brendshme të IAL dhe bazuar në specifikat e veçanta të programit të studimit elementet e aktiviteteve akademike janë:<br>- Leksione 6-12 orë mësimore në javë<br>- Seminare 6-8 orë mësimore në javë<br>- Studio/projekt/workshope 12-18 orë mësimi<br>- Laboratorë 18-25 orë mësimore<br>- Ushtrime/Detyra 1-d orë<br>- Praktikë 20-25 orë<br><br>*RVB; Aneksi Nr.14.1* |
| **Kriteri 2.** Personeli akademik pranon duhet të respektojë dhe t'i përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në | Gjatë takimit të GVJ me mësimdhënësit konstatohet se përdorimi i metodologjive alternative dhe bashkohore në mësimdhënie janë evidente dhe aplikohen rëndomtë nga mësimdhënësit. Rasti i mbajtjes së mësimit virtual përgjatë kohës së pandemisë ishte sfidues.<br><br>Në diskutimet me mësimdhënësit vërehej gatishmëri e madhe për të ju ofruar |

| | |
|---|---|
| përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, reagimet e studentëve dhe është i hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij. | studentëve informatat e fundit bashkëkohore dhe të arriturat në profesionin e Arkitekturë dhe Dizajn Urban.<br><br>***RVB; Aneksi Nr.25*** |
| **Kriteri 3.** Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike, mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. | U_POLIS, mbështet njësitë akademike të saja përmes së cilave përkrahin personelin akademik në mundësinë e diversitetit të mësimdhënies, krijimi i platformës elektronike për ligjëratat virtuale, takimet e rregullta me studentët analiza e nevojave të tyre.<br><br>Puna e mësimdhënësve për punën me studentë në rastet e punimit të diplomave Master janë dëshmi për përsosmërinë e mësimdhënies dhe rritjes së efikasitetit të nxënies.<br><br>***RVB; Aneksi Nr.10; Aneksi Nr.15; Teza dhe Projekt Diploma*** |
| **Kriteri 4.** Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit. | Përgatitja e stafit akademik efektiv dhe me kontratë vlerësuar edhe nga CV-të e tyre personale është adekuat programit të studimeve Master Shkencor i Integruar në Arkitekturë dhe Dizajn Urban.<br><br>Programi i studimit MSc ADU, me lëndët mësimore të cilat janë pjesë e kurrikulës, stafi akademik i rregullt dhe ndihmës ju ofronin studentëve mundësi të mëdha për shpjegime për rastet studimore të dala edhe nga praktikat e realizuara në institucionet vendore.<br><br>***RVB; Aneksi CV Personeli Akademik_FDA*** |
| **Kriteri 5.** Institucioni vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.<br><br>**Kriteri 6.** Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi duke i bërë tërheqëse orët e mësimit. | Arritjet shkencore në profesionin e Arkitekturës zhvillohen me shpejtësi të mëdha në kohën reale. Këto informata mësimdhënësit i kishin të reflektuar në mënyrë periodike në mësimdhënien dhe metodat didaktike të tyre. GVJ konstaton se U_POLIS ishte përkrahëse e përmirësimeve didaktike në mësimdhënie të zbatuar nga mësimdhënësit.<br><br>Gjatë takimeve të GVJ në IAL dhe me takimet e ndara me mësimdhënësit dhe studentët u vërejt se niveli i ofrimit të informatave dhe nxitja e studentëve për të u kyçur në proces të nxënies ishte mbresëlënës.<br><br>***Shënimet në vizitë*** |
| **Kriteri 7.** Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë te studenti, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre | Dinamika e programit të studimit, vizitat në terrene – objekte, duke parë praktikën e mirë dhe jo të mirë, defektet e objekteve të shkaktuara nga tërmeti, shkalla e dëmtueshmërise, lidhja me pjesët teorike të mësimeve në auditor, ushtrimeve, laboratorëve, puna praktike e studentëve janë tërësi e këtij programi të studimit për të cilën studenti duhet të jetë pjesë aktive e aktiviteteve akademike. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| Standardi III.3<br>Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor. | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht. | Duke ju referuar materialeve të IAL atëherë sipërfaqet e hapësirave janë si më poshtë:<br>**Kati Zero** Sipërfaqja 1799 m²<br>Mjedis i përbashkët<br>Korridori 175 m²<br>Sallë kompjuterash 180 m²<br>Korridoret në katin zero 327 m²<br>Mjediset për veprimtaritë akademike<br>Klasa A2 75 m²<br>Klasa A3 120 m²<br>Klasa A4 75 m²<br>Klasa A5 120 m²<br>Klasa A6 75 m²<br>Klasa A8 75 m²<br>Klasa A10 Laboratori i Modelimit 30 m²<br>Laboratori I mjedisit 75 m²<br>Innovation Factory IF 60 m²<br>Laboratori i Efiçiencës Energjetike 70 m2<br>Laboratori i Fotografisë 10 m²<br>Mjediset për veprimtaritë administrative<br>Zyra e Informacionit 10 m²<br>Sekretaria mësimore 47 m²<br>Zyra juridike/Protokolli 25 m²<br>Zyra e financës dhe e Shërbimeve 25 m²<br>Zonat e shërbimit<br>Mjedis për fotokopjim 41 m²<br>Arkiva 43 m²<br>Magazinat 27 m²<br>Mirëmbajtja 30 m²<br>Nyje hidrosanitare për Personelin 11 m²<br>Nyje hidrosanitare për Studentët 68 m²<br>Nyje hidrosanitare për personat me aftesi te kufizuar 5 m²<br>**Kati i parë** Sipërfaqja 1801 m²<br>Mjedis i përbashkët<br>Korridori Kati 1 348 m²<br>Mjediset për veprimtaritë akademike<br>Laboratori 3D MAC Lab ( Mezanina 1) 52 m²<br>Laboratori PC Lab (Mezanina 2) 85 m²<br>Klasa B1 72 m²<br>Klasa B3 142 m²<br>Klasa B4 72 m²<br>Klasa B5 72 m²<br>Klasa B6 Laboratori i Mjedisit 175 m²<br>Klasa B8 145 m²<br>Qendra MAD 172 m²<br>Mjediset për aktivitetet administrative<br>Rektorati/ Administratori 45 m²<br>Kancelari 16 m²<br>Sekretaria e Rektoratit 18 m²<br>Zyra për Personelin 50 m²<br>Zyra e PhD 50 m²<br>Box 18 m²<br>Zonat e shërbimit<br>Salla për Bibliotekë në POLIS 155 m²<br>Salla interneti 23 m²<br>Nyje hidrosanitare për Personelin 14 m²<br>Nyje hirosanitare për Studentët 70 m² |

| | |
|---|---|
| | Nyje hidrosanitare për Invalidët — 7 m$^2$<br>**Kati i dytë** — Sipërfaqja 1541 m$^2$<br>Mjedis i përbashkët<br>Korridori i Katit 2 — 385 m$^2$<br>Mjedise për veprimtaritë akademike<br>Klasa C1 — 216 m$^2$<br>Klasa C2 — 140 m$^2$<br>Klasa C3 — 66 m$^2$<br>Klasa C4 — 140 m$^2$<br>Klasa C6 — 140 m$^2$<br>Mjedise për<br>Dekani i FAD — 11 m$^2$<br>Dekani i FPMMU — 12 m$^2$<br>Zv/dekani i FAD, FPMMU — 17 m$^2$<br>NJBSC dhe Koordinatorët e Programeve Master — 23 m$^2$<br>Zyrë e personelit — 50 m$^2$<br>Zyrë për palë të treta (CO-PLAN) — 150 m$^2$<br>Zyrë për palë të treta (Metro_POLIS) — 77 m$^2$<br>Box — 12 m$^2$<br>Zonat e shërbimit<br>IT — 9 m$^2$<br>Nyje hidrosanitare për Personelin — 15 m$^2$<br>Nyje hidrosanitare për Studentët — 72 m$^2$<br>Nyje hidrosanitare për Invalidët — 6 m$^2$<br>**Kati i tretë** — Sipërfaqja 615 m$^2$<br>Zonat e shërbimit<br>Kantina — 563 m$^2$<br>Nyje hidrosanitare për Studentët — 28 m$^2$<br>Nyje hidrosanitare për Invalidët — 7 m$^2$<br>Mjedisi i jashtëm<br>Oborr — 3,864 m$^2$<br>Parkim nëntokësor — 1,400 m$^2$<br>**Sipërfaqe totale** — **11,020 m$^2$**<br><br>Sipërfaqja e përgjithshme e ambienteve te IAL për stafin është 11,020 m$^2$<br>Bazuar në shënimet e IAL, kjo sipërfaqe e objektit është e mjaftuar për numrin e studenteve marr parasysh që në nivel vendi numrat e studenteve ne ardhje janë duke u ulë.<br><br>*Aneksi Nr.42; Aneksi Nr.42.1 deri 42.6, Planimetri* |
| **Kriteri 2.** Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor, por edhe praktikave. | Ambientet e dedikuara për procesin mësimor në objektin e fakultetit, janë funksionale, me hapësira të mjaftueshme për studentët dhe stafin akademik për të zhvilluar veprimtarinë mësimore.<br><br>*Aneksi Nr.42; Aneksi Nr.42.1 deri 42.6, Planimetri* |
| **Kriteri 3.** Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor. | U_POLIS ka sistem të mirë të ndërtuar përsa i përket bibliotekës. Brenda IAL funksionon Biblio_POLIS e cila siguron tituj dhe literature duke përfshi libra dhe materiale të printuara dhe elektronike , të cilët i përkasin disiplinave të ndryshme por, kryesisht, degëve të Planifikimit Urban, Shkencave Kompjuterike, Art dhe Dizajnit, Arkitekturës, Studimeve Mjedisore, Shkencave Sociale, Inxhinieri Ndërtimi, Shkenca Ekzakte, etj. Këto materiale bashkëkohore përfshijnë tekste të rëndësishme të shkruara në gjuhët primare të folura e të kuptuara në Shqipëri: Shqip, Anglisht, Italisht. |

| | |
|---|---|
| | Përveç Biblo_POLIS, me fond mbi 10.000 tituj librash në format fizik, IAL ka krijuar mundësinë e qasjes në dy nga libraritë më të larmishme në nivel ndërkombëtar, sikurse janë **EBSCO** dhe **JSTOR**. Çdo anëtar i komunitetit POLIS, mund ti përdori këto thesare për të thelluar njohuritë dhe dijet në fushat e interesit. Ju mund të qasja këto dy biblioteka online duke klikuar mbi secilën prej tyre. Përdorimi i tyre është shumë i lehtë dhe tepër komod.<br><br>GVJ konstaton se IAL përdor sistemin e menaxhimit të të dhënave të studentëve. Sistemi mundëson menaxhimin e integruar të të dhënave për programet akademike dhe kurrikulat përkatëse, stafin akademik dhe studentët.<br><br>Sistemi menaxhon në kohë reale lidhjen interaktive student/pedagog, syllabusin e lëndës dhe materialet didaktike të hedhura nga pedagogu (leksione, materiale te ndryshme), frekuentimin e studentit/lëndë, vlerësimet e studentit (vlerësimi i vazhduar dhe ai përfundimtar/lëndë) etj. Studenti në kohë reale ka qasje në ecurinë akademike të tij (lista e notave të lëndëve të shlyera, detyrimet akademike të pashlyera etj). http://www.universitetipolis.edu.al/ |
| **Kriteri 4.** Literatura bazë dhe ndihmëse, e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara për programin e studimit. | GVJ konstaton se studentët kanë qasje në literaturën që disponon Fakulteti dhe Universiteti në format fizik, pranë bibliotekës dhe atë online në dy platformat.<br><br>Janë numër i konsiderueshëm i literaturës që ju ofrohen studentëve për nevojat e studimeve dhe në gjuhë shqipe si dhe gjuhë të huaj. Plafromat e e-library në të cilat IAL është parapaguar ofrojnë avantazhe të mëdha për studentët. *GVJ në takim me studentët vlerëson punën e studentëve në shfrytëzim të literaturës që ofrohet nga IAL.*<br><br>***Aneksi Nr.45*** |
| **Kriteri 5.** Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor. | Biblioteka e institucionit ofron mbi 1000 tituj, te ndare neper seksione, duke përcaktuar titujt e formimit te përgjithshëm, nga ato te profilit.<br><br>Ne takimet me stafin akademik, rezulton se literatura e detyruar gjendet ne biblioteke. |
| **Kriteri 6.** Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit. | Biblo_POLIS, me fond mbi 10.000 tituj librash në format fizik, mundësinë e qasjes në dy nga e-library më të larmishme në nivel ndërkombëtar, sikurse janë **EBSCO** dhe **JSTOR**.<br><br>Qasja e pa kufizuar per mësimdhnesit si dhe për studentet në 24 orë. |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 7.** Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike, shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët. | IAL ka investuar dhe synon të vazhdojë në sigurimin e kushteve optimale infrastrukturore si edhe në teknologjinë bashkëkohore për të mundësuar mësimdhënie të një cilësie të lartë për të inkurajuar eksperimentimin dhe arritje të punëve kërkimore.<br><br>U_POLIS aktualisht ka 5 laboratorë në brendësi të tij në shërbim të programit të studimit.<br><br>1. Laboratori i CAD/SAP/ETABS/TEKLA<br>2. Laboratori i MAC<br>3. Laboratori i Qeramikës<br>4. Laboratori i Pikturës/Ilustrimit<br>5. Laboratori i Prototipizimit – i pasuruar me shume pajisje te reja.<br>6. Laboratori i Fotografisë<br>7. Laboratori i Efiqiences Energjetike<br>8. Laboratori i ri kompjuterësh për lende – digjital Architecture<br><br>Të gjithë këta laboratorë janë shumë të rëndësishëm për programin e studimit Master i Shkencave i integruar në Arkitekture dhe Dizajn Urban.<br><br>GVJ konstaton se IAL disponon infrastrukturën e nevojshme për realizimin e objektivave mësimore. Sallat e leksioneve/seminareve janë të pajisura me PC, projektorë. Biblioteka dhe laboratorë. Për përgatitjen e diplomave studenti shfrytëzon si bazën e literaturës në hard copy ashtu edhe literaturë nga interneti apo biblioteka të tjera on-line në mjediset e bibliotekës. |
| **Kriteri 8.** Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre. | IAL ka krijuar llogari Universitare në platformën G suite (*G Suite Education, Google*) e cila lejon përdorimin e Google Classroom, për hapjen e një klase virtuale dhe se studentët kanë të krijuar akauntin (studenti@universitetiPOLIS) duke ju krijuar qasje në literaturë si dhe shërbime dhe njoftime në kohë reale.<br><br>Me anë të sistemit të menaxhimit të mësimit G suite, pedagogët përdorin llogarinë e tyre të lëndëve individuale, të hapura nga zyra e IT. Nëpërmjet platformës pedagogët ndajnë shënimet e leksioneve, studentët dorëzojnë projektet ose detyrat, kryejnë dhe aktivitete të tjera të ngjashme, të nevojshme për lëndën specifike. |
| **Kriteri 9.** Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar. | Studentët dhe stafi përdorin sistemin (*G Suite Education, Google*) për shpërndarjen e informacionit, ruajtjes së të dhënave, menaxhimit të projekteve apo grupeve të punës. Gjithashtu përdoren platforma GoToMeeting dhe *e*-mail zyrtar me domenin http://www.universitetipolis.edu.al/ . |
| **Kriteri 10.** Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre | IAL ka të hartuar rregulloren e Diplomimit e cila i referohet programit të Studimit Master Shkencor i Integruar në Arkitekturë dhe Dizajn Urban. Kjo rregullore i ndihmon dhe udhëzon studentët mbi rregullat, afatet e realizimit të diplomës si dhe me standardet e realizimit të punimit.<br><br>Me urdhër të MAS Nr. Prot. 2432/10 të datës 10.09.2020 rregullohet modeli i |

| | |
|---|---|
| | diplomës që respektohet nga IAL, përkatësisht nga FAD për programin MSc ADU. FAD, përkatësisht DAI, programi i MSc ADU, ka të hartuar syllabusin e Teza dhe Projekt Diploma i cili përmban aktivitetet e studentit që duhet të përmbushen gjatë semestrit të dhjetë - të fundit të studimeve.<br><br>FAD, përkatësisht Departamenti i Arkitekturë dhe Inxhinieri me stafin akademi të tij zhvillojnë procedura bashkëkohore të punës me studentët për hartimin e diplomave, puna intensive, progresi i punës i përcjellur nga stafi akademik në mënyrë të vazhdueshme, ndihma dhe përkrahja me literaturë janë veprimet që GVJ i gjeti gjatë takimeve me stafin dhe studentët.<br><br>*Aneksi Nr.10; Aneksi Nr.15; Teza dhe Diploma.pdf* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi III.4**<br>**Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programin e studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. | U_POLIS monitoron plotësimin e standardeve të mësimdhënies, duke ju nënshtruar periodikisht proceseve të akreditimit.<br><br>Personeli akademik dhe ai ndihmës akademik pranë Universitetit POLIS, dhe konkretisht ai i Fakultetit Arkitekture Dizajn, janë të angazhuar në mënyrë të vazhdueshme për të garantuar realizimin e objektivave të programit të studimit për Master Shkencor i Integruar në Arkitekturë dhe Dizajn Urban.<br><br>Në përputhje me objektivat strategjike të IAL ka qartë të përcaktuara edhe në Statut dhe rregullore, prioritetin për sigurimin e cilësisë, përmes Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (organ kolegjial). NJSBC është organi që bashkërendon veprimtarinë e vet me strukturat përgjegjëse në çdo fakultet, në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.<br><br>Rektori i U_POLIS ka përcaktuar koordinatoret e programit të cilët, në bashkëpunim me NJSBC, e mbikëqyrin procesin mësimor. Përveç këtyre strukturave, kontrolli dhe mbikëqyrja bëhen edhe nga departamenti dhe Fakulteti në bashkëpunim me NJSBC-n. Këto njësi bëjnë edhe përhapjen dhe promovimin e eksperiencave të përparuara në mësimdhënie dhe mësimnxënie.<br><br>***RVB, Aneksi Nr.; Aneksi Nr.17, Aneksi Nr.30; Aneksi Nr.37.*** |
| **Kriteri 2.** Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së | Organet kolegjiale të U_POLIS duke filluar nga Senati i Universitetit, Këshillat e Fakulteteve, Rektorati etj. hartojnë politikat Institucionale |

| | |
|---|---|
| vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programin e studimit që ofron. | me qëllim sigurimin e cilësisë të aktiviteteve akademike. Trajnimet e ndryshme të organizuara për stafin akademik lidhur me ngritjen e cilësive në mësimdhënie janë aktivitete për të cilat kujdeset IAL.<br><br>Njësitë akademike përkatësisht FAD dhe Departamenti Arkitekturë dhe Inxhinieri janë përgjegjës për sigurimin e cilësisë duke monitoruar dhe vlerësuar studentët pastaj vlerësimet e studentëve për pedagogët, pedagogët vlerësojnë kolegët dhe vetëvlerësimi.<br><br>Anëtaret e departamentit dhe fakultetit trajnohen vazhdimisht nga NJSBC dhe ekspertet e jashtëm te kontraktuar me këtë objekt. Eksperienca e fituar ka ndihmuar në përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja në mësimdhënie, kërkim shkencor dhe fushën e sigurimit të cilësisë.<br><br>Strukturat nxisin studentët që të jenë pjesë e procesit të evidentimit dhe përmirësimit të cilësisë në mësimdhënie.<br><br>*RVB, Aneksi Nr.8, Aneksi 9.* |
| **Kriteri 3.** Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies. | Hapësirat, Laboratorët përkatësisht Infrastruktura e IAL, asetet brenda Institucionit si dhe stafi akademik me veprimtarinë e vet duke përdorur metoda praktike dhe të avancuara e bëjnë këtë program të studimeve jashtëzakonisht të lakmuar për të studiuar.<br><br>*GVJ vlerëson përpjekjet e vazhdueshme që Institucioni inkurajon personelin akademik të zhvillojë metoda të reja në mësimdhënie duke u përshtatur me zhvillimet e programit të studimit.*<br><br>Organizimi i konferencave të ndryshme ndërkombëtare, Workshopeve nga IAL janë tregues dhe matës të mundësive që Universiteti ju ofron stafit akademik dhe studentëve.<br><br>http://www.universitetipolis.edu.al/?q=sq/node/53<br><br>Gjithashtu Laboratorët, lab e projektimit dixhital i përditësuar me pajisje dhe programet të reja shërbejnë për arritjen e kompetencave të studentëve njëkohësisht edhe ngritjes së cilësisë në mësimdhënie nga pedagogët e programit të studimit MSc ADU.<br><br>*RVB, Aneksi Nr.17.* |
| **Kriteri 4.** Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. | Stafi Akademik i angazhuar (Efektiv apo me kontratë) ka përgatitje profesionale të fushave të Arkitekturës dhe Dizajnit Urban.<br><br>Institucioni ka të zhvilluara aktivitetet shkencore, studimore, hulumtuese, të mbështetura në shumë faktorë nga të cilët meritor janë padyshim përveç personelit Akademik edhe pjesa tjetër e personelit që përcjell punën me Studentët.<br><br>Pjesëmarrja e personelit akademik në punë kërkimore është e vazhdueshme, si përmes aktiviteteve që organizon universiteti, ashtu |

| | |
|---|---|
| | edhe në aktivitete të tjera shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare.<br><br>Ndërkohë, kualifikimi i vazhdueshëm i personelit akademik, sidomos përmes kryerjes së studimeve të doktoratës në Polis apo në universitete të huaja, apo pjesëmarrjes në projekte ndërkombëtare, rezulton me impakt konkret në cilësinë e mësimdhënies.<br><br>Gjithashtu edhe personeli tjetër ndihmës janë Laborantët që menaxhojnë laboratorët dhe pajisjet e tyre, janë kontribues në përmirësimin dhe avancimin e mëtejmë. Studentëve ju ofrohet edhe zyra e IT-së e cila asiston në mënyrë të vazhdueshme për të gjithë të interesuarit.<br><br>Gjatë vizitës së GVJ në ambientet e IAL, përkatësisht laboratorëve u vërejt puna me studentët në proces të mësim nxënies cilësore.<br><br>Të gjitha këto shërbime që ju ofrohen Studentëve, kanë për qëllim që të jetë siguruar cilësia e mësimdhënies, dëshira për të studiuar thellësisht dhe arritja e kompetencave profesionale në nivelin çfarë kërkon tregu vendor dhe i jashtëm. |
| **Kriteri 5.** Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja. | U_POLIS mbështet personelin akademik dhe atë ndihmës akademik duke iu ofruar mundësinë për trajnime të ndryshme në fushën e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, Sikur janë trajnimet "In Home" me partner të ndryshëm ndërkombëtarë, cikli i trajnimit MATRA me IHS Erasmus mbështetur nga Qeveria Holandeze. |
| **Kriteri 6.** Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik janë përgjegjës për zbatimin e programit të studimit dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja. | GVJ konstaton se në statut dhe strategjinë e zhvillimit, institucioni përcakton se personeli akademik dhe ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimit dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe zbatimin e metodave të reja. Përgjegjësi i departamentit përgjigjet për ecurinë e punës kërkimore shkencore dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, duke respektuar lirinë akademike dhe kërkimore të personelit akademik<br><br>U_POLIS ofron mbështetje institucionale duke vënë ne dispozicion të personelit akademik infrastrukturë mbështetëse (laboratorë, ambiente, sisteme/ programe informatike, biblioteka etj.<br><br>GVJ, gjatë takimeve me drejtuesit dhe stafin akademik, konstaton se Fakulteti Arkitekturës dhe Dizajnit, periodikisht në fund të vitit akademik analizon punën kërkimore dhe mësimore duke evidentuar arritjet dhe mangësitë, si dhe përcakton ecurinë për të ardhmen<br><br>*Aneksi Nr.2* |
| **Kriteri 7.** Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në | NJSBC dhe Fakulteti vënë në fokusin e tyre metodat e mësimdhënies. Referuar takimeve me stafin dhe NJSBC evidentohet te jene organizuar seminare, leksione të hapura, konsultime, workshop-e etj., për metodat e reja, me pjesëmarrjen e të gjithë personelit akademik të U_POLIS.<br><br>Sfidat qe solli periudha e pandemisë ishin një shtyse qe ndihmoi institucionin |

| | |
|---|---|
| strukturat dhe njësitë përgjegjëse. | ne implementimin e metodave novatore të mësimdhënies.<br><br>Projektet Erasmus pjesë e së cilave ishte dhe është IAL kanë dhënë shtytje dhe mundësi afrimi të metodave të reja të mësimdhënjes. |
| **Kriteri 8.** Institucioni, në kuadër të bashkëpunimeve dhe përfshirjes së partnerëve në procesin mësimor, angazhon në faza të ndryshme të programit të studimit lektorë dhe kërkues shkencorë për shkëmbim të ideve dhe metodave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor | Gjatë vizitës së GVJ në IAL në takimet me stafin akademik, prezent ishin edhe staf ndërkombëtar i angazhuar në programin e studimit MSc ADU.<br><br>Nga bashkëpunimet e U_POLIS me institucionet ndërkombëtare nga GVJ vërehej përfshirja e pedagogëve të huaj të cilët organizonin mësimin në gjuhë angleze.<br><br>IAL ka të realizuara marrëveshje bashkëpunimi me institucione nga të cilat ftonin edhe mësimdhënës për tematika shumë specifike.<br><br>*RVB, Aneksi Nr.34* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi III.5**<br>**Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e kërkimore dhe garanton zbatimin e tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët. | Kriteret dhe mënyra e testimit dhe e vlerësimit të njohurive, aftësive, kompetencave profesionale përcaktohen ne rregulloret e institucionit, rregulloren e programit. Në këto rregullore janë parashikuar elementet e procesit të vlerësimit si detyra kursi, punë në grup, provimet e ndërmjetme dhe përfundimtare.<br><br>Mënyra e vlerësimit përcaktohet edhe në syllabuset e çdo lënde në bazë të specifikave të saj. Studentet njihen me këto rregullore si një e drejtë dhe detyrim i tyre, si dhe janë parashikuar si pjesë përbërëse e kontratës së shkollës dhe studentit. Ato janë të publikuara dhe studentët mund t'i qasen në çdo moment. Procesi i vlerësimit përgjithësisht rezulton te jete:<br><br>- 10 % pjesëmarrja dhe aktivizimi<br>- 25 % Test teorie<br>- 56 % Projekt<br>- 10 % Angazhimi dhe cilësia ne përgatitje.<br><br>GVJ konstaton se kjo përqindje e pjesëmarrjes së vlerësimeve për studentët është e qëndrueshme dhe kontinuale gjatë zhvillimit të mësimit.<br><br>*RVB; Aneksi Nr.19 Syllabusi Gjeometri dhe dokumentim Grafik.pdf* |
| **Kriteri 2.** Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve | Në rregulloret e U_POLIS dhe në rregulloret e tjera të provimeve apo të programit që e plotësojnë atë, përcaktohet detyrimi për të informuar studentët në fillim të çdo moduli/ lende me metodologjinë e testimit dhe të vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/ modulit. Referuar takimeve me stafin dhe studentet, rezulton te jete realizuar një proces i tille. |

| | |
|---|---|
| nga titullari i lëndës/modulit. | Studentët njihen me kriteret dhe mënyrat e vlerësimit nëpërmjet sqarimit nga ana e pedagogut të lëndës të syllabusit përkatës.<br><br>*Aneksi Nr.2; Aneksi Nr.4; Aneksi Nr.5; Aneksi Nr.6.* |
| **Kriteri 3.** Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara | Sipas Rregullores se provimeve, testimi i njohurive dijeve dhe aftësive të fituara nga studentët realizohet duke vlerësuar me pikë pjesëmarrjen dhe aktivizimin, detyrat e kursit, (projekte etj.), laboratorët, provimet e ndërmjetme dhe provimit përfundimtar. Në nivel programi studenti vlerësohet edhe për praktikën dhe detyrimet përmbyllëse për mbrojtjen e diplomës.<br><br>Teza e provimit hartohet duke kombinuar pyetjet me alternativa, zbërthim konceptesh, ushtrime praktike si dhe ushtrime të ndryshme sipas lëndës. Mënyra e vlerësimit dhe shpërndarja e pikëve brenda lëndës bëhet sipas modelit të detajuar (model teze) gjithsej 100 pikë, por mbetet në kompetencë të pedagogut përgjegjës të lëndës shpërndarja e peshës specifike për secilin komponent të vlerësimit.<br><br>*Aneksi Nr.9; Aneksi Nr.4; Aneksi Nr.5; Aneksi Nr.6.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi III.6**<br>**Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar. | Gjatë takimeve të GVJ me studentët e programit të studimeve Master Shkencor i Integruar në Arkitekturës dhe Dizajn Urban vërtetoj se studentët vlerësohen në mënyrë të vazhdueshme gjatë procesit të zhvillimit të mësimit.<br><br>Duke qenë programi i studimit Arkitekturë dhe Dizajn Urban, puna më e madhe e studentëve në lëndët me karakter formues janë të natyrës me peshë të madhe dhe se puna gjatë semestrit kryesisht realizohet në detyra projektuese me vëllim pune të konsiderueshëm, prandaj vlerësimi i vazhdueshëm për këto studime është i pa zëvendësueshëm.<br><br>*Shënime në vizitë* |
| **Kriteri 2.** Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën. | Kujdesi për vlerësimet e studentëve nga mësimdhënësit, organizimi i testimeve, mënyra e mbajtjes së tyre vlerësohet se është brenda standardeve akademike dhe nuk mund të ketë abuzim.<br><br>U_POLIS ka një sistem elektronik të ruajtjes së shënimeve të studentëve i cili është i qëndrueshëm dhe shumë funksional, ndërsa ju shërben studentëve dhe mësimdhënësve G store – Google Clasroom. |
| **Kriteri 3.** Testimi përfundimtar i vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e posaçme me së paku 2 anëtarë, të ngritura nga | Vlerësim përfundimtar realizohet nga komisionet e provimeve (jo më pak se 2 pedagogë, nën drejtimin e titullarit të lëndës) të ngritura nga departamentet dhe të miratuara nga Dekani i Fakultetit, siç parashikohet nga Rregullorja e përgjithshme e IAL-së. |

| | |
|---|---|
| njësitë përgjegjëse, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit. | *Aneksi Nr.10.* |
| **Kriteri 4.** Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe/ose kamera sigurie. | Programi i studimeve MSc ADU, përkatësisht studentët e këtij programi, detyrat projektuese të vëllimeve të mëdha të punës gjatë semestrit edhe vlerësohen me pjesën më të madhe të provimit bëhen publike nëpër studiot e projektimit dhe se ruajtja e anonimitetit për këtë program studimi nuk mund të kërkohet.<br><br>Format e kontrollit parashikohen në rregulloren e provimeve. Teza përgatitet nga titullari i lëndës dhe asistenti ose një anëtar tjetër i komisionit. Pedagogu shpall rezultatet dhe sekretaria identifikon emrin me rezultatin në fletën e provimit. Institucioni vë në dispozicion të studentëve për realizimin e provimeve sallat e leksioneve, që janë të pajisura me kamera, për monitorimin e procesit të provimit. |
| **Kriteri 5.** Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/ feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen. | Vlerësimi i njohurive behet sipas rregullave të U_POLIS. GVJ nga dokumentacioni dhe takimi me studentët konstaton se në kontrollin e dijeve vlerësohen dijet dhe puna individuale e studentit. Nëpërmjet komunikimit të drejtpërdrejtë, stafi akademik gjatë orëve të seminareve u ofron studentëve komente /feedback për performancën e tyre lidhur me përvetësimin e njohurive gjatë seminareve/testimeve të ndërmjetme, nivelit të përgatitjes/prezantimeve të detyrave të kursit/projekteve, duke iu dhënë këshilla/orientime për përmirësimin e perfomancës në të ardhmen.<br><br>*Aneksi Nr.7* |
| **Kriteri 6.** Njësitë përgjegjëse dhe stafi akademik evitojnë dhe nuk tolerojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra. | Departamenti dhe personeli akademik bazohen ne rregulloren e provimit dhe të etikës lidhur me mënyrën e mbikëqyrjes, dhe të masave ndëshkuese në rast plagjiaturë gjatë procesit të provimit. Përsa i përket detyrave të kursit dhe kryesisht të punimeve të diplomave, personeli akademik dhe drejtuesit e departamentit dhe Fakultetit, orientojnë/miratojnë tematika kryesisht aplikative ose gjysmë aplikative, ku të dhënat që përdoren (kryesisht te punimet e diplomave) të jenë autentike.<br><br>Çdo anëtar i stafit akademik dhe jo akademik sipas detyrave të ngarkuara është përgjegjës për garantimin e një niveli të lartë të ndershmërisë në çdo kohë dhe rrethanë, referuar draft kontratës se pedagogut dhe Rregullores së Etikës. |
| **Kriteri 7.** Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse. | GVJ, gjatë vizitës në Sekretarinë mësimore konstaton që vlerësimi kryhet me sistem prej 10 notash. Nota me e ulet kaluese është 5. Rezultatet e provimit ju bëhen të njohura studentëve nga sistemi Pitagora, ose edhe me komunikim verbal dhe individual, në departament.<br><br>Gjatë vitit pedagogët janë të lirë të alternojnë metodat kontrolluese dhe vlerësuese të cilat përfshijnë kontroll të vazhdueshëm nëpërmjet provimeve, teste me pyetje alternative, kuize, prezantime ne grup ose individuale, etj.<br><br>*Aneksi Nr.9; Aneksi 46, Sistemi Pitagora* |
| **Kriteri 8.** Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur | Referuar takimit me studentet, ata njohin te drejtën e tyre për ankimim. Mbas |

| | |
|---|---|
| me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit. | shpalljes se rezultateve paraprake nga pedagogu në sistem, studenti ka të drejtën e kontestimit të mundshëm brenda afateve të përcaktuara në rregullore. Mbas kontestimit të notës nga studenti, kërkesa e tij për rivlerësim shqyrtohet nga komisioni i provimeve dhe pedagogu i lëndës të cilët më pas vendosin për notën përfundimtare.<br><br>Mbas kësaj faze, sërish studenti ka të drejtën e kontestimit të notës në instanca më të larta, ku kërkesa shqyrtohet me një komision të veçantë.<br><br>*Aneksi Nr.6; Aneksi Nr.7.* |
| **Kriteri 9.** Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet | Kërkesa për ankimim note shqyrtohet nga komisioni fillestar apo komisionet e tjera të ngritura, duke respektuar rregulloren e provimeve dhe rregulloret e tjera që lidhen me procesin e provimeve në U_POLIS.<br><br>*Aneksi Nr.7* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi III.7**<br>**Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuri të thelluara të kompetencave profesionale e shkencore.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve. | Plani mësimor i programit të studimit përfshin lwndw teorike shkencore nw fushën e arkitekturës, praktiken profesionale dhe diplomën. Kjo kurrikul parapërgatit studentwt për mundësinë e vazhdimit tw studimeve tw ciklit tw tretw.<br><br>Syllabuset e lëndës paraqesin objektivat, aftësitë dhe kompetencat që fiton studenti në lëndën përkatëse.<br><br>Departamenti ofron shërbime shtesë krahas procesit mësimor, të tilla si konsultime apo leksione të hapura. Stafi akademik përfshin studentet në veprimtari jashtëkurrikulare. Gjithashtu, shkëmbimet e studenteve ndihmojnë në përthithjen e aftësive në fushën e ndërtimit.<br><br>Studentet përfshihen edhe në veprimtarinë kërkimore të stafit. Ato inkurajohen për të punuar në grup gjatë procesit mësimor. Në seminare organizohen diskutimet e çështjeve të caktuara duke i ndarë studentët në grupe sipas roleve që do të luajnë dhe secili grup përfaqëson një grup interesi.<br><br>IAL ka krijuar një bazë komunikimi dhe marrëdhëniesh, e cila i siguron kushte dhe mundësi për të realizuar praktikat mësimore dhe internshipe për studentët. Në politikat e tij, U_POLIS punon për zgjerimin e mëtejshëm të bashkëpunimit me institucione arsimore si dhe me organizatat e biznesit dhe institucionet shtetërore.<br><br>Projektet kërkimore kanë në fokus bashkëpunimet në fushën kërkimore, |

| | |
|---|---|
| | mobilitetin e studentëve dhe stafit akademik.<br><br>*Aneksi Nr.19, Aneksi Nr.14.1* |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj). | GVJ në takime me studentët vërtetuan se studentët zhvillojnë lëndë të CAAD-it të cilat ju ofrojnë aftësi të konsiderueshme, ndërsa edhe lëndët projektuese i përgatisin studentët me softwar-ët profesional të fushave të arkitekturës sikur janë Revit, AutoCAD, etj.<br><br>Punimi i Tezave dhe diplomës në Arkitekturë për kohën e sotshme pa përdorimin e softwer-ve profesional është e pa mundur të paramendohet, prandaj edhe FAD dhe DAI janë shumë të vetëdijëshëm për këtë çështje, prandaj progresi i studentëve është në kohë reale. |
| **Kriteri 3.** Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. | Referuar takimit me stafin akademik, *GVJ konstaton se pedagoget e lëndës informojnë studentet mbi kompetencat e fituara që duhet të demonstrojnë në provim.* Studentët orientohen në lidhje me strukturën dhe natyrën e pyetjeve që do të përmbajë provimi final dhe gjithashtu si dhe për peshën që do të ketë në notën finale të lëndës në provimin final.<br><br>Syllabuset e lëndës/modulit paraqesin përmbajtjen e saj, dhe ndarjen sipas veprimtarive formuese, kreditet dhe orët përkatëse. Objektivat, aftësitë dhe kompetencat janë paraqitur ne syllabus. Këto elemente qe detajohen ne çdo lende janë pjese e objektivave te përgjithshme te programit.<br><br>*Aneks.7: Syllabuset e lendeve* |
| **Kriteri 4.** Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre dhe testin përfundimtar. | Referuar takimit me stafin akademik, GVJ konstaton, pedagogwt e lwndws informojnë studentet mbi kompetencat e fituara që duhet të demonstrojnë në profesion. Studentët orientohen në lidhje me strukturën dhe natyrën e pyetjeve që do të ketë provimi final dhe gjithashtu edhe për peshën që do të ketë në notën finale të modulit provimi final. |
| **Kriteri 5.** Personeli akademik (i brendshëm ose i ftuar) realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit. | Stafi akademik i departamentit angazhohet në aktivitete shkencore, në konferenca dhe simpoziume workshope, si dhe zhvillon leksione në institucione ndërkombëtare në kuadër të Erasmus+. Gjithashtu, nëpërmjet marrëveshjeve me IAL të tjera iu është krijuar mundësia e mbështetjes konkrete për kërkimin shkencor. |
| **Kriteri 6.** Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. | Studentët e programit MSc në Arkitekturë dhe Dizajn Urban kanë në dispozicion laboratorë të ndryshëm si dhe mundësinë e zhvillimit të praktikës profesionale. Përsa i përket përgatitjes profesionale dhe zhvillimit të kompetencave të studentëve, Departamenti bashkërendon punën e vet me strukturat e tjera, duke i asistuar ne zhvillimin e praktikave profesionale, gjë që përbën edhe një objeksion gjatë zhvillimit të saj. |
| **Kriteri 7.** Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara. | GVJ, gjatë takimit me stafin akademik konstaton se studentët inkurajohen për të punuar në grup në zgjidhjen e detyrave të shtëpisë apo të kursit, gjatë procesit mësimor, në praktika, laboratorë etj. Kjo punë realizohet nën drejtimin e pedagogut udhëheqës apo të lëndës.<br><br>Puna në grup mbi interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave të ndryshme përbën një ndër kompetencat e programit MSc në Arkitekturë dhe Dizajn |

| | |
|---|---|
| | Urban.<br>*Aneksi Nr.14.1* |
| **Kriteri 8.** Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje te studenteve. | *GVJ konstaton se në Departament ka klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative dhe kërkimore, në bashkëpunim me studentët.* Kërkimi shkencor aplikohet përmes stimulimit të inovacionit në projekte shkencore dhe projekte të shoqërisë civile. Në IAL janë funksionale qendrat kërkimore. |
| **Kriteri 9.** Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato. | IAL është promovuese e vlerave akademike dhe kërkimore që ju referohet programit të studimit MSc i Integruar në Arkitekturë dhe Dizajn Urban Vetë programi MSc ADU, përmbajnë thellësi të shkencave të Arkitekturës dhe Dizajnit Urban nga të cilat studentët gjejnë inspirimin për krijimin e veprave arkitektonike bashkëkohore.<br>U_POLIS ofron një gamë marrëveshjesh institucionale Fakulteteve për mundësi të shfrytëzimit të tyre për interesa të përgjithshme. |
| **Kriteri 10.** Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve | *GVJ konsideron dhe vlerëson marrëveshjet institucionale të arritura me institucionet ndërkombëtare* si dhe përfshirja e U_POLIS në projekte të ndryshme të cilat forcojnë programet e studimeve në Arkitekturë dhe Dizajn Urban duke ju ofruar studentëve dhe stafit akademik mundësi të përfshirjes sa më të madhe.<br>Të gjitha projektet dhe marrëveshjet mundësojnë moblitete të studentëve si dhe stafit akademik.<br>*Aneksi Nr.34* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi III.8**<br>**Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës, para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike. | U_POLIS parashikon procesin e diplomimit të studentëve në tërësi në aktet e brendshme rregullative. Rregullorja e Fakultetit shpreh procesin e diplomimit të studentëve që studiojnë në FAD. IAL ka të miratuar rregulloren specifike të diplomimit ku janë të përcaktuara procedurat, formatet dhe modalitetet e mbrojtjes së diplomës.<br>Rregullorja shpjegon të gjithë procesin e diplomimit të studentëve të cilët janë pjesë e IAL. FAD ka rregulloren e veçantë me të cilën përcaktohen procedurat e diplomimit, format dhe modalitetet e mbrojtjes etj.<br>*Aneksi Nr.10* |
| **Kriteri 2.** Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në | Sipas ligjit të arsimit të lartë 80/2015, programi i studimit MSc duhet të përmbajë temë diplome. IAL në programin e studimit Msc i Integruar në Arkitekturë dhe Dizajn Urban e përmbush këtë kërkesë ligjore duke |

| | |
|---|---|
| dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës. | organizuar diplomat MSc. Rregulloret e brendshme institucionale zbatohen në mënyrë korrekte dhe i ndihmojnë studentët si dhe pedagogët në procedura.<br><br>Pedagogët punojnë me studentët, i orientojnë, i ndihmojnë të punojnë në mënyrë të pavarur dhe ndajnë materialet që mund t'i ndihmojnë ato të kryejnë punën e tyre kryesisht kërkimore. Udhëheqësi i punimit përgatit programin e punës së studentit, duke përcaktuar afatet për realizim.<br><br>Departamenti miraton tezat e diplomës. Studentët informohen paraprakisht lidhur me procedurat për diplomën përmes mësimdhënësve të njësisë akademike – departamentit.<br><br>*Aneksi Nr.10* |
| **Kriteri 3.** Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final, bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike. | GVJ konstaton se, rregullorja e IAL për procedurat e përgatitjes dhe mbrojtjes së punimit të diplomës për programin e studimit MSc ADU, përcakton qartë dhe radhit veprimet që duhet të realizojë studenti hap mbas hapi , si dhe veprimet e institucionit.<br><br>Nga institucioni ngrihet një komision për mbrojtje të temës së diplomës. |
| **Kriteri 4.** Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të tezës/diplomave. | Nga takimet e GVJ u vërtetua se secili nga pedagogët e programit të studimit – bartësit e lëndëve përgatit një listë të temave të diplomave. Departamenti i Arkitekturë dhe Inxhinieri i miraton temat e diplomave si dhe bartësit e tyre. Nuk përjashtohet mundësia edhe e propozimit të temës së diplomës nga vetë studenti.<br><br>Mësimdhënësit ndihmojnë studentët duke i orientuar në fushat e studimeve dhe duke ju siguruar informata paraprake dhe literature të nevojshme për realizimin e punimit të diplomës. Studenti konsultohet dhe ndihmohet nga udhëheqësi si dhe një konsulenti. |
| **Kriteri 5.** Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit. | Laboratorët brenda U_POLIS janë në dispozicion për shfrytëzimin e tyre nga studentët. Në rastin kur natyra e temave të diplomave kanë nevojë për ekzaminime, institucioni i ndihmon studentët edhe jashtë IAL, për realizimin e tyre. Të gjitha mjediset e U_POLIS janë në shërbim të studentëve së bashku me administratën, personelin akademik dhe ndihmës.<br><br>*Shënime në vizitë* |
| **Kriteri 6.** Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.<br><br>**Kriteri 7.** Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë. | Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve dhe konkluzioneve, ndihmon në zgjedhjen e probleme si dhe asiston në analizë sintetike.<br><br>Punimi përmban rezultatet dalëse, analiza të vlerave si dhe përfundime për të cilat udhëheqësi i punimit ka përgjegjësi dhe duhet të garantoj për vlera të pa cenueshme të punimeve.<br><br>Punimi i diplomës vlerësohet me notë nga komisioni i mbrojtjes së diplomave. Secili anëtarë vlerëson punimin në mënyrë të pa varur. Vlerësimi komunikohet në prani të komisionit studentit nga kryetari i komisionit. |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 8.** Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. | Pas përfundimit të diplomimit, studenti pajiset me diplomë dhe me suplementin e diplomës nga Ministria e arsimit..<br>*Aneksi Nr.15.* |
| **Kriteri 9.** Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar. | Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion diploma si dhe suplementi i diplomës.<br>*.Aneksi Nr.5* |
| **Kriteri 10.** Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen | Këto dokumente si dhe procesverbalet e provimeve, ruhen pas diplomimit, në arkivin e institucionit dhe më pas, sipas ligjit për arkivat. Të dhënat origjinale të studentit i kthehen atij, ndërsa institucioni ruan kopje të njësuar me origjinalin në formë hardcopy dhe elektronike.<br>Universiteti arkivon dokumentacionin e studentit pas diplomimit në zyrat e arkivës. Rast pas rasti, bazuar në kërkesat specifike të studentëve, lëshohen vërtetime për qëllime të ndryshme. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

## IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

| **Standardi IV.1**<br>**Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit për programin e studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësimor-shkencor dhe administrativ. | Nga vizita në zyrën e burimeve njerëzore rezulton se informacioni mbi personelin e angazhuar në programin e studimit është i plotë dhe ruhet në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi. Në kontratat vjetore të personelit akademik janë të detajuara ngarkesa mësimore dhe angazhimi për vitin akademik.<br>Gjithashtu, në dokumentacionin shoqërues të RVB, është dhënë informacion i plotë mbi angazhimin e personelit akademik, ndihmësakademik dhe koordinatorin e programit të studimit për tre vitet e fundit akademike.<br>*Shënime gjatë vizitës; Aneksi Nr. 24; Aneksi Nr. 25* |
| **Kriteri 2.** Institucioni harton dhe | Rekrutimi i personelit akademik zhvillohet në përputhje me strategjinë e |

| | |
|---|---|
| zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit. | menaxhimit të burimeve njerëzore të universitetit. Procedurat e rekrutimit fillojnë në Departament dhe më pas përcillen në zyrën e burimeve njerëzore për shpalljen publike. Përzgjedhja e kandidatëve kryhet nga komisioni i ngritur për këtë qëllim, i cili vlerëson përmbajtjen e aplikimit dhe zhvillon intervista.<br><br>Për procedurat e rekrutimit, komunikimi mes njësive dhe strukturave të burimeve njerëzore kryhet përmes emaileve dhe nuk u evidentua dokumentacion zyrtar i depozituar në një sistem protokollimi të brendshëm.<br><br>*Shënime gjatë vizitës; Aneksi Nr. 11* |
| **Kriteri 3.** Institucioni harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike. | Procedura e parashikuar nga universiteti për rekrutimin e personelit akademik paraqitet në vijim:<br><br>- *Shpallja e vendit vakant nga Departamenti/Fakulteti përgjegjës;*<br>- *Shpallja e njoftimit të vendit vakant nga Zyra e Burimeve Njerëzore (në faqen elektronike, rrjete sociale dhe zyra e punës);*<br>- *Aplikantët/kandidatët mund të dorëzojnë dokumentacionin e kërkuar në formë elektronike sipas thirrjes së shpallur;*<br>- *Pas mbylljes së datës së aplikimeve, sipas rastit dhe llojit të vendit vakant ngrihet komisioni i përbërë nga: Rektori/Zv. Rektori/Administratori, Dekan, Përgjegjës Departamenti, Staf me përvojë në fushën përkatëse, Përgjegjësi i Burimeve Njerëzore;*<br>- *Zyra e Burimeve Njerëzore njofton me e-mail, kandidatët të cilët janë zgjedhur për intervistë/prezantim pune;*<br>- *Pas përfundimit të intervistave me kandidatët pjesëmarrës, komisioni del me vendimin nëse kandidati pranohet;*<br>- *Zyra e Burimeve Njerëzore në zbatim të vendimit përkatës njofton me email, kandidatët të cilët kanë marrë pjesë në intervistim;*<br>- *Bordi i Administrimit zbardh vendimin për stafin e ri;*<br>- *Pas nxjerrjes së vendimit, Zyra e Burimeve Njerëzore, kërkon dokumentacionin e nevojshëm dhe hap dosjen elektronike dhe fizike për çdo staf të ri;*<br>- *Në bashkëpunim me zyrën e financave, Administratori dhe Juristi hartojnë draft kontratën e cila i vihet në dispozicion stafit në fjalë;*<br>- *Kontrata nënshkruhet nga stafi me kohë të plotë/pjesshme dhe rektori.*<br>- *Stafi deklarohet si staf me kohë të plotë/pjesshme në Drejtorinë e Përgjithshme të taksave.*<br>- *Zyra e Burimeve Njerëzore njofton me e-mail gjithë stafin.*<br><br>*Aneksi Nr. 44* |
| **Kriteri 4.** Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, | Thirrjet për pozicionet vakante shpallen në faqen zyrtare të universitetit. Në njoftim paraqiten kriteret që duhet të përmbushë kandidati si: fusha e ekspertizës, eksperienca në mësimdhënie, niveli i kualifikimit, njohuritë mbi gjuhën e huaj etj.<br><br>*http://www.universitetipolis.edu.al/?q=sq/node/367* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit | | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [redacted] | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | X |

| **Standardi IV.2**<br>**Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efiçente dhe efektive** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale. | Infrastruktura e universitetit paraqet të gjitha lehtësitë e nevojshme për ushtrimin e aktivitetit akademik. Kjo infrastrukturë, siç u konstatua gjatë vizitës në institucion, përmbush nevojat në terma sasiore dhe cilësore duke krijuar kushte pune të mira dhe motivuese.<br>Investimet e viteve të fundit kanë mundësuar zhvillimin e mëtejshëm të infrastrukturës laboratorike, që krijon mundësi të mëtejshme për zhvillimin e kërkimit shkencor.<br>*Shënime gjatë vizitës; Aneksi Nr. 42 – 42.6* |
| **Kriteri 2.** Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit. | Personeli akademik i programit të studimit ka mundësi të kualifikohet në programet e studimit të ofruara nga universiteti ose në aktivitetet e zhvilluara në kuadër të projekteve të bashkëpunimit. Aktualisht, një pjesë e personelit akademik janë duke ndjekur programin e studimeve të doktoratës të ofruar nga universiteti.<br>*Shënime gjatë vizitës; RVB* |
| **Kriteri 3.** Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor. | Në RVB përmenden disa trajnime të realizuara në lidhje me metodat e mësimdhënies dhe përdorimin e teknologjive. Gjithsesi, nga takimi me personelin akademik u konstatua se Departamenti nuk ka një kalendar periodik për trajnime të personelit akademik dhe se në trajnimet e zhvilluara ka qenë i përfshirë vetëm një pjesë e vogël të stafit.<br>Përtej kësaj, periudha e pandemisë COVID 19 mundësoi aftësimin e stafit në forma alternative komunikimi të cilat përmirësojnë komunikimin me studentin.<br>*Shënime gjatë vizitës; RVB* |
| **Kriteri 4.** Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programit të studimeve të ciklit të dytë | Numri i personelit akademik, ndihmësakademik dhe administrativ i përfshirë në programin e studimit përmbush të gjitha pritshmëritë për realizimin cilësor të programit. Kualifikimi i personelit duket se ka një përmirësim të vazhdueshëm, por mbetet ende sfidë kualifikimi i të gjithë personelit akademik me formim të ciklit tretë. Ndërkohë vihet re edhe një ngarkesë e lartë në lidhje me aktivitetin në auditor. Referuar Aneksit 25, disa ngarkesa vjetore janë më të mëdha se 600 orë. Po ashtu, angazhimi në një numër të lartë lëndësh / modulesh vlerësohet si element i mbingarkesës. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | *Aneksi Nr. 24; Aneksi Nr. 25* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

**Standardi IV.3**

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik e kërkimor, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.**

| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
|---|---|
| **Kriteri 1.** Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse. | Nga vizita në institucion rezulton se infrastruktura në shërbim të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor është një nga pikat e forta të këtij programi studimi. Ambientet e mësimdhënies janë të bollshme (8.6 $m^2$/student) dhe të pajisura me elementët e nevojshëm për funksionimin e tyre. Laboratorët dhe biblioteka janë gjithashtu elemente mjaft të rëndësishëm në shërbim të kërkimit shkencor dhe studentëve.<br><br>Studiot e projektimit dhe ambientet e punës për studentët janë ambiente specifike që lidhen me programin e studimit. Këto ambiente kanë kushte mjaft të mira për punën në grup dhe për aktivitetet tipike që duhet të zhvillohen në një shkollë arkitekture.<br><br>*Shënime gjatë vizitës; Aneksi Nr. 42 – 42.6* |
| **Kriteri 2.** Mjediset mësimore, si: klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies. | Nga vizita e ambienteve u evidentua se sallat e mësimdhënies janë të pajisura me teknologjinë dhe pajisjet e nevojshme për realizimin e plotë të procesit mësimor. Në total rezultojnë 25 hapësira të dedikuara për mësimdhënien, prej të cilave 8 janë laboratorë. Këtu nuk përfshihen biblioteka dhe 2 salla informatike në shërbim të studentëve. Këto ambiente përdoren nga të gjitha programet e studimit të universitetit, ku programi i studimit MSc në Arkitekturë dhe Dizajn Urban ka numrin më të madh të studentëve.<br><br>*Shënime gjatë vizitës; Aneksi Nr. 42 – 42.6* |
| **Kriteri 3.** Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimit teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi. | Laboratorët:<br>- Laboratori i CAD/SAP/ETABS/TEKLA<br>- Laboratori i MAC<br>- Laboratori i Qeramikës<br>- Laboratori i Pikturës/Ilustrimit<br>- Laboratori i Prototipizimit – i pasuruar me shume pajisje te reja.<br>- Laboratori i Fotografisë<br>- Laboratori i Efiqiences Energjetike<br>- Laboratori i ri kompjuterësh për lende – digjital Architecture<br>- Qendra MAD<br>Laboratorët rezultojnë të pajisur me instrumente utilitare dhe të avancuara në shërbim të aktiviteteve të programit të studimit. Këtu vlen të veçohet Innovation Factory e cila është pajisur me pajisje teknologjike të rilevimit |

| | |
|---|---|
| | dhe printimit tredimensional, si dhe me teknologjinë virtual reality.<br>*Shënime gjatë vizitës; Aneksi Nr. 42 – 42.6* |
| **Kriteri 4.** Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron. | Laboratori 3d MAC Lab dhe Laboratori PC Lab ofrojnë mundësi për studentët që të shfrytëzojnë kompjuterë të pajisur me programet profesionale kryesore që përdoren për projektimin arkitektonik dhe vizualizimin. Gjithashtu, në shërbim të studentëve është edhe një sallë kompjuterësh dhe një sallë interneti.<br>*Shënime gjatë vizitës; Aneksi Nr. 42 – 42.6* |
| **Kriteri 5.** Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike | Një pjesë e kapaciteteve për zhvillimin e aktiviteteve praktike ofrohen nga vetë institucioni përmes infrastrukturës së lartpërmendur. Mundësi të mëtejshme për zhvillimin e praktikave profesionale ofrohen nga bashkëpunimet e institucionit me universitete partnere, institucione publike, kompani private, zyra projektimi, etj.<br>*Aneksi Nr. 32* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi IV.4**<br>**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit. | Biblioteka e universitetit zë një sipërfaqe prej 155 m2 dhe është e mirë pajisur me tituj të lidhur drejtpërdrejt me disiplinat kryesore të programit të studimit. Kjo bibliotekë, megjithëse me një sipërfaqe të kufizuar, është një nga bibliotekat më të mira në vend për fushën e arkitekturës ku mund të aksesohet literaturë e huaj dhe vendase.<br>*Shënime gjatë vizitës; Aneksi Nr. 42 – 42.6* |
| **Kriteri 2.** Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit. | Biblioteka e universitetit ka një fond prej mbi 10 000 librash, të grupuar sipas disiplinave në vijim:<br>- Arkitekturë<br>- Shkenca Kompjuterike / IT<br>- Art dhe Dizajn<br>- Planifikim Urban<br>- Studime Mjedisore<br>- Administrim Biznesi<br>- Eficencë Energjetike<br>Një pjesë e katalogut mund të qaset në mënyrë virtuale përmes faqes |

| | |
|---|---|
| | elektronike të universitetit ku paraqiten titujt kryesorë në gjuhën shqipe dhe të huaj. Literatura e ofruar, së bashku me bibliotekën elektronike dhe abonimet në periodikë profesionalë ofrojnë një sfond të plotë për përmbajtjen e programit të studimit si dhe për thellimin në kërkim shkencor. *http://www.universitetipolis.edu.al/?q=sq/node/1335* |
| **Kriteri 3.** Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët, në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit. | Përtej katalogut fizik, një burim mjaft i vlefshëm është edhe katalogu online i cili mundëson aksesin në literaturë dhe artikuj shkencorë. Për këtë qëllim janë aktive dy platformat EBSCO dhe JSTORE. Përmes këtyre dy bibliotekave mundësohet akses në një databazë të gjerë me informacion shkencor dhe profesional ku përfshihen edhe disiplinat e lidhura me programin e studimit.<br><br>*http://www.universitetipolis.edu.al/?q=sq/node/1335* |
| **Kriteri 4.** Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve. | Salla e bibliotekës është e pajisur me kompjuter ku mund të aksesohet katalogu. Gjithsesi, informacioni për një pjesë të katalogut mund të merret edhe online dhe studenti mund të paraqitet për të konsultuar drejtpërdrejtë informacionin në bibliotekë. Në raport me numrin e studentëve, vendet e studimit në bibliotekë janë të kufizuara. Rekomandohet krijimi i një kapaciteti studimi / leximi për të paktën 10% të numrit të studentëve aktivë.<br><br>*Shënime gjatë vizitës* |
| **Kriteri 5.** Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit. | Në konsultim me personelin akademik, fondi i bibliotekës shtohet vazhdimisht duke përzgjedhur literaturë cilësore të lidhur drejtpërdrejt me programin e studimit. *Përtej koleksionit të bibliotekës, krijimi i një fondi të veçantë me tezat e masterit të aksesueshme për studentët dhe të interesuarit do të ishte një vlerë e shtuar e bibliotekës.*<br><br>*Shënime gjatë vizitës* |
| **Kriteri 6.** Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj | Oraret e operimit të bibliotekës janë 8.30-16.30 në ditët e javës, ndërsa gjatë zhvillimit të programeve master biblioteka është e hapur edhe në fundjavë gjatë orarit 9.00-17.00. ***Rekomandohet që biblioteka të funksionojë me orë të zgjatura gjatë sesionit të provimeve, duke i ardhur në ndihmë studentëve me literaturë dhe hapësirë studimi edhe në orët e pasdites.***<br><br>*Shënime gjatë vizitës* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi IV.5**<br>**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë | Sistemi i menaxhimit të informacionit që përdor universiteti quhet "Pitagora" dhe është vënë në përdorim prej vitit 2019. Ky sistem mundëson ndërveprimin e të gjitha strukturave me informacionin e studentëve duke |

| | |
|---|---|
| informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit. | mundësuar dokumentimin e punës dhe aksesin në informacion. Përmes sistemit ruhen të dhënat mbi ecurinë e studentit, frekuentimi, kreditet dhe rezultatet e fituara.<br>*RVB; https://polis.pitagora.rash.al/login* |
| **Kriteri 2.** Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit. | Pitagora është e lidhur edhe me zyrën juridike dhe me zyrën e financës ku administrohet informacioni dhe dokumentacioni për personelin e universitetit. Kjo bën të mundur që informacioni të aksesohet me lehtësi dhe të jetë i përditësuar.<br>*RVB; https://polis.pitagora.rash.al/login* |
| **Kriteri 3.** Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit. | Lidhja në sistem realizohet përmes kredencialeve të përdoruesit, që në varësi të hierarkisë institucionale ka nivel të diferencuar aksesi në të dhëna. Praktikisht, platforma mundëson ndërveprimin si student, personel akademik dhe personel administrativ, duke ofruar nivelin përkatës të aksesit në informacion. Njëkohësisht, këto kategori mund të ndërveprojnë me njëra tjetrën duke shkëmbyer informacion.<br>*RVB; https://polis.pitagora.rash.al/login* |
| **Kriteri 4.** Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve. | Krahas sistemit të menaxhimit, U_POLIS ka dhe dhe qasje institucionale të autorizuar në platformën *Google Education*, që është përdorur masivisht gjatë pandemisë: *Google Classroom* dhe *Google Handouts* për ndërveprimin e drejtpërdrejtë mes stafit dhe studentëve.<br>*RVB; Shënimet e vizitave.* |
| **Kriteri 5.** Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët. | Sistemi është programuar që të mund të gjeneroje raporte të ndryshme si për stafin drejtues, akademik ashtu dhe për administratën e IAL. |
| **Kriteri 6.** Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe | Faqja elektronike e universitetit është e pasur dhe e përditësuar me informacion të përgjithshëm dhe specifik mbi programin e studimit.<br>Informacioni mbi programin e studimit përmban profilin kulturor dhe profesional të programit, çështjet kryesore që trajtohen dhe mundësitë e punësimit. Ky informacion është i disponueshëm në shqip dhe anglisht.<br>Në faqen zyrtare janë të publikuar edhe profilet e personelit akademik sipas njësive përbërëse të universitetit.<br>*http://www.universitetipolis.edu.al/?q=en/node/1622*<br>*http://www.universitetipolis.edu.al/?q=en/node/1858* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi IV.6**<br>**Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi. | Zhvillimi financiar prezantohet përmes Strategjisë Financiare të universitetit e cila përshkruan modelin e biznesit të aplikuar dhe qasjen për një menaxhim efikas dhe rritje të kapaciteteve.<br><br>Universiteti e sheh veten si një biznes social që operon si një organizatë jofitimprurëse.<br><br>Skema e administrimit bazohet në një buxhet afatmesëm 3-vjeçar i cili zbërthehet në buxhete operative vjetore. Në hartimin e buxheteve analizohen kostot e programeve të studimit me synim garantimin e qëndrueshmërisë financiare të tyre.<br><br>Vitet e fundit, të ardhurat nga projektet ndërkombëtare kanë ardhur në rritje, duke ndikuar ndjeshëm në zhvillimin e kapaciteteve, kryesisht atyre të infrastrukturës.<br><br>*RVB; Aneksi Nr. 4* |
| **Kriteri 2.** Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë, sipas natyrës specifike të tij. | Sipas të dhënave të ofruara nga universiteti, kostot e programit të studimit për tre vitet e fundit kanë qenë rreth 262 milionë lekë, ku peshën më të madhe e zënë pagesat për personelin (66%), më pas shpenzimet për didaktikën dhe administrimin (30%) dhe investimet në infrastrukturë fizike dhe laboratorike (4%).<br><br>Duke analizuar numrin e studentëve dhe vijimësinë pozitive të programit, gjykojmë që modeli i zgjedhur i financimit është i suksesshëm dhe i qëndrueshëm.<br><br>*RVB* |
| **Kriteri 3.** Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose | Universiteti realizon procesin e përvitshëm të auditimit të jashtëm ku analizohet modeli financiar dhe të dhënat përkatëse.<br><br>Nga të dhënat e vëna në dispozicion nga universiteti rezulton se ky program studimi financohet në masën 93% nga tarifat e studentëve. 4% e të ardhurave rezultojnë nga projektet e bashkëpunimit dhe fonde nga donatorë (BE), dhe 3% mbulohen nga të ardhurat e universitetit prej realizimit të workshopeve, kurseve dhe programeve të kualifikimit.<br><br>*RVB* |

| | |
|---|---|
| ndarjen e burimeve financiare. | |
| **Kriteri 4.** Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij. | Universiteti dhe programi i studimit paraqesin qëndrueshmëri financiare, por, megjithatë, kanë varësi të lartë të modelit financiar nga tarifat e studimit. Ambicia e paraqitur është që niveli i të ardhurave dytësore të mbërrijë në 20% në vitet e ardhshme, nga rreth 10% që është sot. Diversifikimi i ofertës akademike brenda universitetit redukton riskun për programin MSc ADU por nuk shihet si zgjidhje e qëndrueshme afatgjatë.<br>Në vijim të zhvillimit të mëtejshëm të universitetit dhe programit të studimit, rritja e të ardhurave të gjeneruara nga aktiviteti kërkimor dhe projektet e zhvillimit do të krijonin një model më elastik.<br>*RVB; Aneksi Nr. 4* |
| **Kriteri 5.** Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen | Gjatë 10 viteve të fundit, universiteti ka provuar stabilitetin financiar të programit të studimit, duke prodhuar rritje të interesit dhe treguesve të matshëm. Përmes interesit të studentëve në rritje garantohen edhe burimet bazë për këtë program studimi.<br><br>Rritja e numrave të studentëve ka pasur një trend rritës me rreth 15% në vit për vitet e fundit. Me këtë trend pozitiv, sfida e ardhshme e programit të studimit do të jetë zgjerimi i kapaciteteve pritëse pa cenuar cilësinë akademike. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV** | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

| **Standardi V.1 Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore. | Programi është i strukturuar sipas legjislacionit kombëtar për arsimin e lartë. Politikat dhe procedurat e ndjekura nga institucioni garantojnë rrugëtimin normal të studentëve; nga pranimi deri në diplomim.<br><br>Organizimi i studimeve dhe procedurat e pranimit përshkruhen në statutin e institucionit dhe në rregulloren e funksionimit të universitetit. Rregullorja parashikon edhe transferimin dhe njohjen e krediteve dhe periudhave të studimit nga institucione të tjera. GVJ u njoh gjatë vizitës edhe me raste konkrete të studentëve të transferuar dhe shqyrtoi dokumentacionin përkatës.<br><br>Rregullorja e institucionit parashikon gjithashtu edhe modalitetet e diplomimit, duke strukturuar kështu të gjitha etapat e që ndjek studenti gjatë ciklit të |

| | |
|---|---|
| | studimit.<br>*Shënime gjatë vizitës; Aneksi Nr. 5* |
| **Kriteri 2.** Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit. | Procedura e pranimit është e hapur për të gjithë studentët që kanë përfunduar studimet e gjimnazit në Shqipëri (ose ekuivalentin e tyre), pa diskriminim apo politika të pabarabarta përzgjedhjeje përveç meritës.<br>Kandidatët pranohen përmes në një test pranimi. Testi zhvillohet me shkrim dhe përmes intervistës.<br>Kandidatët e pranuar njihen me të drejtat dhe detyrimet e tyre përmes rregullores mësimore të programit të studimit.<br>Në vijimin e studimeve, deri në diplomimin e tyre, madje edhe pas diplomimit, studentët asistohen nga zyra e karrierës së universitetit.<br>Politikat e mundësive të drejta dhe të barabarta për të gjithë zbatohen gjatë gjithë kohëzgjatjes së programit, deri në diplomim.<br>*Shënime gjatë vizitës; Aneksi Nr. 7* |
| **Kriteri 3.** Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.<br>**Kriteri 4.** Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e dytë të studimeve. | Kriteret dhe procedurat e pranimit janë të disponueshme online në faqen web të universitetit. Ky seksion ofron informacione edhe për kandidatët nga trevat shqiptare jashtë Shqipërisë.<br>Informacioni mbi aplikimin dhe dokumentacionin shoqërues ofrohet në dy gjuhë, shqip dhe anglisht. Gjithashtu, informacioni i pranimit ofrohet edhe përmes rrjeteve sociale apo portalit U_Albania.<br>Kriteret e shpallura për vitin akademik 2021-2022 janë miratuar nga senati akademik dhe shpallur përmes portaleve të komunikimit. Këto kritere janë në përputhje me udhëzimet e MAS dhe me legjislacionin në fuqi.<br>Pranimi në programin MSc ADU, bazohet në mbledhjen e pikëve të grumbulluara nga mesatarja VKM (30%) + pikët e fituara në testin e formimit të përgjithshëm i cili zhvillohet në U_POLIS (70%).<br>Mesatarja e shkollës së mesme për kandidatët duhet të jetë të paktën 6.5.<br>*http://www.universitetipolis.edu.al/?q=sq/node/144*<br>*https://ualbania.al/pages/fakultete.html?id=33* |
| **Kriteri 5.** Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni i arsimit të lartë udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit | Mënyra të tjera informacioni janë të disponueshme drejtpërdrejt në universitetin Polis duke kontaktuar Zyrën e Pranimeve e cila informon dhe asiston në mënyrë të vazhdueshme kandidatët potencialë.<br>Në faqen web të kësaj zyre gjendet informacioni i plotë mbi pranimet dhe mbi mundësitë për bursa të kandidatëve të interesuar.<br>*http://www.universitetipolis.edu.al/?q=sq/node/2635* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi V.2**<br>**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. | Përmes sistemit të informacionit Pitagora, studenti merr informacion të plotë në lidhje me gjendjen e tij, frekuentimin, vlerësimet dhe strukturën e planit të studimit.<br>Informacion i mëtejshëm ofrohet përmes Statutit, Rregullores së programit të studimit dhe Rregullores së institucionit. Këto dokumente janë të aksesueshme nga studentët, të cilët asistohen në mënyrë të vazhdueshme nga personeli akademik dhe administrativ.<br>*Aneksi Nr. 2; Aneksi Nr. 5; Aneksi Nr. 7* |
| **Kriteri 2.** Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme. | Ky informacion ofrohet për çdo të interesuar, duke shqyrtuar dokumentacionin përkatës dhe duke vlerësuar masën e njohjes së studimeve të zhvilluara më parë. Vlerësimi përfundimtar kryhet nga një komision i posaçëm i ngritur nga Dekani.<br>Procedura e plotë parashikohet në Nenin 11 të Rregullores së programit të studimit.<br>*Aneksi Nr. 7* |
| **Kriteri 3.** Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit. | Syllabuset e lëndëve janë me mundësi të qasjes përmes portalit Pitagora dhe çdo student mund të qaset te ato. Në syllabus përshkruhen modalitetet e vlerësimit për lëndën përkatëse.<br>Informimi i vazhdueshëm zhvillohet edhe në auditor përmes kontaktit drejtpërdrejtë me personelin akademik.<br>*Shembull Sylabusi: Studio dhe Teori Arkitektur 2B* |
| **Kriteri 4.** Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit. | Referuar rregullores së institucionit dhe vizitës së kryer, modalitetet e diplomimit janë:<br>Në përfundim të plotë të programit të studimit, studentët kanë të drejtë të diplomohen nëpërmjet mbrojtjes së një teme diplome.<br>Studenti duhet të përgatisë diplomën dhe të ketë kryer konsultimet e organizuara me udhëheqësin sipas grafikut të konsultimeve përcaktuar. Studenti duhet të ketë kryer të paktën 3 kontrolle të suksesshme gjatë procesit të diplomës të organizuara nga Departamenti, në të cilat kontrollohet volumi i punës së kryer dhe cilësia e kryerjes së tyre.<br>Studenti pajiset me vlerësimin me shkrim nga oponenti pas kompletimit të projektit final.<br>Studenti nuk mund të mbrojë temën e diplomës pa shlyer më parë të gjitha detyrimet dhe pa fituar numrin e krediteve siç parashikohen nga plani mësimor.<br>*Shënime gjatë vizitës; Aneksi Nr. 5* |
| **Kriteri 5.** Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në | Institucioni ka një seri broshurash dhe materialesh informative të cilat përdoren për komunikim dhe përcjellje informacioni tek të interesuarit. Zyra e Pranimeve |

| | |
|---|---|
| mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit | organizon në mënyrë periodike takime në gjimnaze dhe shkolla profesionale, si dhe merr pjesë në aktivitete të organizuara nga MAS. Në vitin 2020, për shkak të pandemisë COVID19, një pjesë e aktiviteteve janë zhvilluar online. <br> *Aneksi Nr. 51* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [redacted] | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi V.3** <br> **Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve. | Gjatë takimit me studentët u vu re se ata kishin një shkallë të mirë të informacionit për programin dhe organizimin e tij. Ata janë në kontakt të vazhdueshëm me personelin akademik dhe administrativ nga të cilët marrin asistencën e vazhdueshme dhe të nevojshme. |
| **Kriteri 2.** Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese. | Takimet e rregullta me personelin akademik shërbejnë për t'u ofruar studentëve të gjithë informacionin përkatës rreth kurseve dhe aktiviteteve të tjera programore. <br> Informacion i hollësishëm mbi lëndët ofrohet përmes syllabuseve të cilat u vihen studentëve në dispozicion në çdo fillim të aktivitetit mësimor. <br> Shumica e informacionit bazë është i aksesueshëm edhe përmes portalit Pitagora. <br> *Shënime gjatë vizitës* |
| **Kriteri 3.** Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës. | Zyra e karrierës ofron mbështetje dhe informacion në lidhje me mundësitë e punësimit, nëpërmjet rrjetit të partnerëve të universitetit. Një listë e rrjetit të partnerëve është ofruar nga institucioni si pjesë e dokumentacionit mbështetës të RVB. <br> Siç paraqitet nga të dhënat e zyrës së karrierës, në tre vitet e fundit, 78/89 të diplomuar janë punësuar në profesion. <br> *Aneksi Nr. 29; Aneksi Nr. 32* |
| **Kriteri 4.** Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. | Siç u vu re në vizitën në institucion (takimi me studentët), studentët janë në kontakt të vazhdueshëm me personelin dhe të mirëinformuar rreth shërbimeve, kurseve dhe aktiviteteve të tjera të programit të studimit. Duke marrë parasysh numrin relativisht të vogël të studentëve dhe shtrirjen e kufizuar të infrastrukturës së universitetit, komunikimi rezulton të jetë i lehtë dhe efikas. <br> *Shënime gjatë vizitës* |
| **Kriteri 5.** Informacioni në lidhje me programin e studimit | Sistemi i menaxhimit të brendshëm PITAGORA disponon të gjithë informacionin e nevojshëm lidhur me Programin e Integruar të Studimeve |

| | |
|---|---|
| mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë. | Master i Shkencave i Integruar në Arkitekturë dhe Dizajn Urban<br>https://polis.pitagora.rash.al/login;<br>http://www.universitetipolis.edu.al/?q=sq/node/2635 |
| **Kriteri 6.** Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin mësimor të studentëve | Informacioni dhe dokumentacioni ruhen si në letër ashtu edhe në formë elektronike, duke përfituar nga platformat online të përdorura nga universiteti. Të dhënat e studentëve mbahen në regjistra të cilët mbahen nga Sekretaria.<br>Portali Pitagora mundëson marrjen dhe depozitimin e informacionit në lidhje me aktivitetin akademik të studentit.<br>*Shih Standardin IV.5* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi V.4**<br>**Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit të ciklit të dytë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit. | Universiteti nuk ka një zyrë të dedikuar për statistikat. Ky funksion mbulohet nga Sekretaria Mësimore e cila mban dokumentacionin e plotë për studentët, ku përfshihen studentët aktivë, studentët e larguar, studentët e transferuar, studentët e diplomuar. Informacioni ruhet në regjistra (hard copy) si dhe në formë elektronike. GVJ mundi të verifikojë regjistrat dhe informacionin bazë të ruajtur nga Sekretaria Mësimore.<br>*Shënime gjatë vizitës* |

**Kriteri 2.** Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimit.

Sekretaria Mësimore mban shënim të gjitha të dhënat në lidhje me numrin e studentëve dhe performancën e tyre. Këto të dhëna janë në dispozicion të departamenteve dhe mund të përdoren për analiza të lidhura me cilësinë.

Siç paraqitet nga universiteti, numri i studentëve në çdo vit akademik është:

| Brezi - Viti akademik i fillimit të studimeve | Të regjistruar | Të transferuar | Të larguar | Të diplomuar |
|---|---|---|---|---|
| 2006-2007 | 41 | 1 | 9 | 32 |
| 2007-2008 | 80 | 0 | 16 | 63 |
| 2008-2009 | 57 | 0 | 13 | 39 |
| 2009-2010 | 61 | 6 | 17 | 45 |
| 2010-2011 | 46 | 4 | 13 | 30 |
| 2011-2012 | 56 | 5 | 15 | 38 |
| 2012-2013 | 35 | 3 | 15 | 18 |
| 2013-2014 | 34 | 5 | 12 | 15 |
| 2014-2015 | 25 | 3 | 5 | 16 |
| 2015-2016 | 43 | 4 | 9 | 27 |
| 2016-2017 | 62 | 3 | 19 | 33 |
| 2017-2018 | 61 | 12 | 18 | 5 |
| 2018-2019 | 72 | 27 | 34 | 4 |
| 2019-2020 | 76 | 4 | 12 | 2 |
| 2020-2021 | 99 | 3 | 9 | 0 |
| 2021-2022 | 132 | 3 | 0 | 0 |

*Aneksi Nr. 27*

**Kriteri 3.** Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimit që nga pranimi, deri në diplomimin e tyre.

**Kriteri 4.** Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.

Të dhënat e studentëve ruhen në përputhje me kërkesat ligjore në Sekretarinë Mësimore dhe mbulojnë të gjithë periudhën në të cilën programi ka qenë aktiv. Të dhënat ruhen në kopje elektronike dhe në regjistra në letër. Vitet e fundit, databaza elektronike menaxhohet përmes sistemit Pitagora.

Të dhënat vihen në dispozicion të njësive për analiza të mëtejshme të lidhura me punën e tyre.

***Shënime gjatë vizitës***

**Kriteri 5.** Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve

Institucioni ka paraqitur një përmbledhje të të dhënave mbi mesataren në hyrje dhe në dalje të studentëve për MSc. ADU. Vihet re se mesatarja në dalje ka shmangie relativisht të vogël nga mesatarja në hyrje, ku në disa raste mesatarja në dalje rezulton më e lartë (brezat 2007-2008, 2013-2014, 2016-2017).

Sekretaria Mësimore është përgjegjëse për analizën periodike të statistikave. Nuk u evidentuan raporte specifike të këtyre analizave apo plane masash të hartuara mbi këto raporte.

Të dhënat mbi punësimin menaxhohen nga zyra e karrierës e cila ndjek studentët edhe pas diplomimit të tyre. *Edhe në këtë rast ekzistojnë të*

| | |
|---|---|
| | *dhënat, por nuk ka raporte të mirëfillta analitike apo plane veprimi.* Një përmbledhje e të dhënave paraqitet në raportin vjetor të institucionit që dorëzohet në MAS.<br><br>***Aneksi Nr. 27; Aneksi Nr. 29*** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi V.5**<br>**Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve. | Këshilli Studentor është organizmi i përfaqësimit të studentëve, funksionimi i të cilit garantohet përmes Statutit të universitetit. Përfaqësuesit e Këshillit Studentor zgjidhen nga studentët dhe kanë mandat dyvjeçar.<br><br>Studentët përfaqësohen në Senatin Akademik me tre përfaqësues; një për çdo fakultet. Gjithashtu një student është pjesë edhe e NJBSC.<br><br>Komisioni i Marrëdhënieve me Studentët është një komision i përhershëm me përbërje nga personel akademik e administrativ, i cili kujdeset për informimin e studentëve, përfshirjen e tyre dhe për konsultimin me ta për proceset që zhvillohen në mjedisin akademik. Ky komision, sipas përcaktimeve të Statutit, trajton edhe orientimin e studentëve në lidhje me tregun e punës dhe me fushat e studimit në universitet. Në fakt, roli i këtij komision duket sikur mbivendoset pjesërisht me punën e zyrës së karrierës.<br><br>***Aneksi Nr. 2; Aneksi Nr. 30*** |
| **Kriteri 2.** Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme. | Nga takimi me studentët u vu re se ata ndihen të përfaqësuar dhe të integruar në mjedisin akademik, duke pasur marrëdhënie komunikimi aktive me autoritetet dhe organet drejtuese, qoftë në baza individuale, ashtu edhe përmes përfaqësuesve të tyre.<br><br>Studentët plotësojnë rregullisht pyetësorin për cilësinë e mësimdhënies, përmes të cilit bëhen pjesë e vlerësimit periodik të personelit akademik.<br><br>***Shënime gjatë vizitës; Aneksi Nr. 40; Aneksi Nr. 41; Aneksi Nr. 46.1*** |
| **Kriteri 3.** Në hartimin dhe përmirësimin e programit të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, | Ngarkesa e programit të studimit është e hartuar në bazë të krediteve (ECTS), me një parashikim normal prej 30 ECTS në semestër, e barabartë me 750 orë studimi në auditor dhe punë e pavarur. Kjo ngarkesë shpërndahet në një kohëzgjatje prej 15 javësh.<br><br>Ngarkesa e programit është e krahasueshme me programe të ngjashme duke iu referuar praktikave evropiane perëndimore dhe atyre lokale. Është për t'u konsideruar se në përgjithësi, programet në Arkitekturë kanë një ngarkesë më të madhe se programet e tjera, e lidhur kjo drejtpërdrejt me natyrën e tyre specifike, |

| | |
|---|---|
| përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme. | bazuar në projekte dhe studio projektimi.<br><br>*Aneksi Nr. 14.1* |
| **Kriteri 4.** Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to. | Përfaqësimi i studentëve i përshkruar në Kriterin 1dhe 2 të këtij standardi garanton praninë e mendimit të tyre në organet akademike. Në votimet në senatin akademik pesha e tyre në vendimmarrje, referuar Statutit, është 15%.<br><br>Nga takimi me studentët rezultoi se ata kanë një komunikim aktiv me personelin akademik, ku shprehin dhe diskutojnë opinionet e tyre në lidhje me përmbajtjen e kurrikulës.<br><br>*Shënime gjatë vizitës* |
| **Kriteri 5.** Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës | Studentët kanë mundësinë e ankimimit sipas një procedure të përshkruar në RVB.<br><br>Në përgjithësi vërehet aplikimi i vlerësimeve të larta, ku studentët ndihen të vlerësuar drejt dhe shprehen të kënaqur.<br><br>*Shënime gjatë vizitës; RVB* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi V.6 Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit merr pjesë në aktivitetet kërkimore e shkencore dhe motivon pjesëmarrjen e studentëve dhe përfshirjen e tyre në studime e projekte.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Personeli akademik merr pjesë në konferenca ose aktivitete ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor. | Personeli akademik i MSc ADU është i përfshirë aktivisht në aktivitetin kërkimor, kryesisht të lidhur me aktivitetet periodike kërkimore të organizuara ose të mbështetura nga vetë universiteti si:<br>- Tirana Design Week<br>- Tirana Architecture Week<br><br>Gjithashtu, përfshirja e personelit akademik në projekte bashkëpunimi ka mundësuar pjesëmarrjen e tyre në aktivitete ndërkombëtare. Këtu duhet theksuar se një pjesë e stafit është duke kryer studimet e doktoratës dhe janë të angazhuar në procese aktive kërkimi së bashku me partnerët e UniFe. |
| **Kriteri 2.** Institucioni lidh marrëveshje partneriteti me institucionet e huaja të arsimit të lartë, institute, me qëllim realizimin e studimeve, projekteve dhe kërkimeve të | Universiteti Polis ka një numër të konsiderueshëm partnerësh akademikë me të cilët bashkëpunon në mënyrë aktive. Vlen për t'u veçuar Universiteti i Ferrarës me të cilin organizohet shkolla e përbashkët e doktoratës.<br><br>*Aneksi Nr. 32* |

| | |
|---|---|
| përbashkëta. | |
| **Kriteri 3.** Personeli akademik motivon studentët të hartojnë, shkruajnë dhe publikojnë studime e punime shkencore. | Puna kërkimore e studentëve zhvillohet kryesisht në kuadër të lëndëve të kurrikulës apo workshopeve të organizuara nga universiteti. Në fakt, puna projektuese ka procese kërkimi të cilat shpeshherë rezultojnë mjaft interesante. Universiteti ka krijuar hapësirën për të publikuar punë të suksesshme të studentëve të zhvilluara gjatë procesit akademik, apo të realizuara nga përfshirja e tyre në projekte bashkëpunimi (TDW, TAW, Forum A+P). |
| **Kriteri 4.** Institucioni mbështet publikimin në revista shkencore ndërkombëtare të punimeve kërkimore shkencore të personelit akademik të institucionit dhe studentëve. | Institucioni ka krijuar një mikroklimë të tijën për kultivimin e kërkimit shkencor përmes organizimit të përvitshëm të konferencave dhe aktiviteteve tematike, si dhe përmes publikimit të Forum A+P, një revistë e konsoliduar tashmë. Përmes këtyre instrumenteve, lehtësohet dhe nxitet puna e personelit akademik për publikime dhe referime shkencore.<br><br>Gjithashtu, nga takimi me personelin akademik u pohua se ka edhe mbështetje për pjesëmarrje në aktivitete që zhvillohen jashtë universitetit.<br><br>*Shënime gjatë vizitës* |
| **Kriteri 5.** Institucioni dhe personeli akademik motivojnë dhe mbështetin studentët të angazhohen në studime inovative dhe patentave. | Universiteti Polis ka një mjedis aktiv me aktivitet akademik ku vlejnë të përmenden workshopet, shkollat verore, projektet e bashkëpunimit dhe konferencat. Pjesëmarrja e studentëve në këto aktivitete mundëson një lidhje të vazhdueshme me informacionin dhe dijen. Megjithëse nuk është evidentuar angazhim i studentëve në zhvillimin e patentave, u konstatua një frymë promovuese për inovacionin (FAB lab, dhe workshopet ndërkombëtare të projektimit). |
| **Kriteri 6.** Personeli akademik ofron asistencën e nevojshme për kryerjen e analizave, matjeve studimeve dhe përpunimit të rezultateve në kuadër të realizimit të diplomës | Temat e diplomave janë kryesisht me karakter projektues, dhe si të tilla, asistenca e personelit akademik fokusohet në konsultimin e projektit dhe në sugjerimin e bibliografisë për thellimin teorik. Gjithsesi, infrastruktura e universitetit është e pasur me instrumente laboratorike apo profesionale të cilat mund të shfrytëzohen nga studentët sipas nevojës.<br><br>*Shënime gjatë vizitës* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [redacted] | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi V.7**<br>**Mbështetja e institucionit të arsimit të lartë siguron vazhdimësi në studime të thelluara dhe kërkim shkencor.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni ndjek një politikë bashkëpunimi me organizmat shkencorë, kombëtarë, me qëllim rritjen e aktiviteteve dhe mobilitetit të stafit dhe studentëve të programit të studimit. | Universiteti Polis përmes partneritetit me universitete të huaja dhe projekteve të bashkëpunimit mundëson mobilitete të studentëve dhe të stafit. Më të shumta në numër janë mobilitetet në kuadër të Erasmus+.<br><br>Megjithëse nuk është raportuar një numër për programin MSc ADU, në nivel universiteti mobilitetet për studentët e ciklitit të parë dhe të dytë rezultojnë rreth 13-14 mobilitete në vit. |

| | |
|---|---|
| | *https://www.universitetipolis.edu.al/?q=sq/node/1974* |
| **Kriteri 2.** Implementimi i metodave të kërkimit nga personeli akademik dhe studentët siguron vijueshmëri dhe përgatitje të studentëve për ciklin e tretë të studimeve. | Programi i studimit është i strukturuar në përputhje me kërkesat ligjore për programet e integruara të ciklit të dytë dhe mundëson vijimin e studimeve në ciklin e tretë. Programi parashikon lëndë të thellimit teorik dhe metodologji të kërkimit të aplikuar.<br>*Aneksi Nr. 19* |
| **Kriteri 3.** Institucioni ndjek një politikë të përfshirjes së studiuesve të rinj në projekte kërkimore vendës dhe të huaj. | Përfshirja e studenteve në projekte të mirëfillta kërkimore rezulton të jetë e limituar. Fokusi i programit është angazhimi i studentëve në workshope, shkolla verore apo aktivitete bashkëpunimi të cilat janë forma klasike e formimit në studimet për Arkitekturë apo Dizajn Urban. |
| **Kriteri 4.** Institucion ndjek një politikë integruese për kërkuesit shkencorë të huaj. | Universiteti Polis ka personel akademik dhe kërkues shkencorë (studentë doktorate) të huaj të cilët janë të lidhur me kohë të pjesshme apo të plotë me universitetin. Gjithashtu, projektet ndërkombëtare dhe bashkëpunimet në të cilat është angazhuar universiteti mundësojnë praninë e vazhdueshme të kërkuesve të huaj në universitet.<br>*Aneksi Nr. 32; Aneksi Nr. 24* |
| **Kriteri 5.** Institucioni ndjek një politikë favorizuese për mobilitetitin e studentëve që angazhohen në veprimtari e aktivitete ndërkombëtare. | Mobilitetet e identifikuara i përkasin kryesisht marrëveshjeve Erasmus+ (shih Kriteri1). Përtej këtyre mobiliteve, nxitet vazhdimisht pjesëmarrja e studentëve në workshope dhe aktivitete ndërkombëtare, por nuk u evidentuan politika të qarta favorizuese të aplikuara nga universiteti për studentët e MSc ADU. |
| **Kriteri 6.** Institucioni, për të rritur profilin ndërkombëtar, fton për veprimtari kërkimore dhe mësimdhënie, personel akademik dhe studentë të huaj, për periudha të ndryshme kohore | Organizimi i studimeve të përbashkëta të doktoratës me Universitetin e Ferrarës dhe workshopet ndërkombëtare të përvitshme janë dëshmi e një mjedisi me prezencë të vazhdueshme të akademikëve dhe studentëve të huaj, të cilët kontribuojnë, jo vetëm në nivelin akademik, por edhe në promovimin dhe ekspozimin ndërkombëtar të universitetit. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [redacted] | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi V.8**<br>**Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve. | Universiteti ka të ngritur zyrën e mbështetjes së karrierës dhe këshillimit të studentëve. Kjo zyrë ofron mbështetje për studentët duke shpërndarë komunikimi në lidhje me mundësitë e punësimit në kompani të ndryshme me të cilat universiteti është në komunikim. Zyra gjithashtu asiston studentët në dhënie informacioni dhe asistence brenda institucionit. Megjithëse zyra ka një network me të cilin mban lidhje të vazhdueshme, nga vizita në terren u vu re se përfshirja e përfaqësuesve të industrisë në strukturat e universitetit (p.sh. njësia e sigurimit |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 2.** Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit. | të cilësisë) nuk realizohet përmes konsultimit me këtë zyrë. Gjithashtu u konstatua se nuk ka një ambient fizik ku kjo strukturë kryen aktivitetin e saj, por detyrat e saj mbulohen nga personel akademik i ngarkuar me këtë detyrë.<br><br>Studentët asistohen gjithashtu nga personeli akademik dhe personat e ngarkuar për koordinimin e proceseve akademike. Ky sistem rezulton të jetë efikas, duke marrë në konsideratë faktin që universiteti ka numër të kufizuar studentësh dhe zhvillon aktivitetin e tij në një ndërtesë të vetme.<br><br>***Shënime gjatë vizitës*** |
| **Kriteri 3.** Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës. | Zyra e mbështetjes së karrierës dhe këshillimit të studentëve realizon kontakte të vazhdueshme me studentët duke ofruar asistencën e nevojshme në lidhje me aktivitetin e tyre, duke u fokusuar kryesisht tek marrëdhëniet me tregun e punës. Këtu vlen të përmendet përfshirja në projektin Gradua, në kuadër të të cilit është realizuar një network profesional me kompani dhe të diplomuar, me qëllim rritjen e komunikimit me tregun e punës dhe promovimin e profesionistëve të rinj.<br><br>Këshillimin e përditshëm studentët e përfitojnë në mënyra të ndryshme, ku mund të përmendim kontaktet me sekretarinë mësimore, personelin akademik dhe drejtuesit e strukturave përgjegjëse për programin e studimit.<br><br>***Shënime gjatë vizitës*** |
| **Kriteri 4.** Zyra/njësi e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse | Duke qenë se universiteti ka një numër relativisht të vogël të të diplomuarve, është e mundur ruajtja e kontakteve dhe marrja e informacionit mbi karrierën e tyre. Zyra e karrierës ka të dhëna të plota dhe informacion mbi ecurinë profesionale të të diplomuarve të programit të studimit, të cilët duket se kanë lidhje dhe komunikim të vazhdueshëm me universitetin.<br><br>***Shënime gjatë vizitës*** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V** | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER I SHKENCAVE/ ARTEVE

| **Standardi VI.1**<br>**Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.<br><br>**Kriteri 2.** Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentë dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm. | Njësia e brendshme e sigurimit të cilësisë rezulton se është funksionale, aktive dhe e mirëstrukturuar. Kjo njësi funksionon në përputhje me Rregulloren e saj ku përcaktohen përgjegjësitë dhe mënyra e organizimit.<br><br>Njësia përbëhet nga 9 anëtar, 5 prej të cilëve janë personel akademik, një përfaqësues i alumni, një përfaqësues i studentëve, një përfaqësues i industrisë dhe një personel nga sekretaria mësimore.<br><br>Njësia realizon pyetësorë periodik dhe trajton problematikat e evidentuara duke i adresuar në strukturat përkatëse të universitetit.<br><br>*Aneksi Nr. 8* |
| **Kriteri 3.** Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë. | Universiteti ka një përvojë mjaft të mirë në realizimin e proceseve të akreditimit ku vihet re një performancë mjaft e mirë dhe përmirësim i vazhdueshëm i cilësisë.<br><br>Njësia e brendshme e sigurimit të cilësisë ka një eksperiencë të vazhdueshme me proceset e akreditimit dhe është pjesë e analizave të vazhdueshme mbi rezultatet e arritura.<br><br>Njësia është trajnuar edhe përmes pjesëmarrjes së universiteti në projekte ndërkombëtare (QainAL). Këto trajnime kanë mundësuar edhe hartimin e procedurave dhe manualeve ndihmëse në procesin e sigurimit të cilësisë.<br><br>*Aneksi Nr. 46; Aneksi Nr. 37* |
| **Kriteri 4.** Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programit të studimit që ofron, në kuadër të SBC-së. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit | Njësia e brendshme e sigurimit të cilësisë, në mbështetje të rregullores së saj, realizon procese të vazhdueshme për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies, cilësisë së ofrimit të shërbimeve administrative dhe analizon rezultatet e këtyre proceseve. Këto procese vlerësimi realizohen në bashkëpunim me Departamentet. Dokumentimi i proceseve paraqitet i hollësishëm në raportin vjetor të njësisë.<br><br>*Aneksi Nr. 37; Aneksi Nr. 8* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| Standardi VI.2<br>**Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programit të studimit të ciklit të dytë. | Mbikëqyrja dhe rishikimi i programit të studimit janë kompetencë e Departamentit i cili koordinon dhe drejton aktivitetin akademik dhe kurrikulën. Në bashkëpunim me NJBSC departamenti analizon rezultatet e vlerësimeve periodike dhe reflekton masat e nevojshme në strukturën e programit. Raporti i paraqitur nga institucioni për këtë proces është raporti vjetor i NJBSC.<br><br>*Aneksi Nr. 37* |
| **Kriteri 2.** Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programit të studimit të ciklit të dytë. | Procesi i vlerësimeve përmblidhet nga NJBSC në raportin vjetor, ku rezultatet janë të paraqitura në nivel njësie kryesore dhe njësie bazë. Të dhënat e përgjithshme ofrohen edhe për performancën e stafit dhe lëndëve.<br><br>Rezultatet diskutohen dhe analizohen në strukturat e universitetit përgjegjëse për programin e studimit.<br><br>*Aneksi Nr. 37* |
| **Kriteri 3.** Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programit të studimit. | Metodologjia e aplikuar për vlerësimin mbështetet kryesisht në pyetësorë dhe në vlerësimin në auditor të personelit akademik. Pyetësorët aplikohen kryesisht për komunikimin me studentët, ndërsa strukturat drejtuese realizojnë vlerësimin e personelit akademik dhe proceseve të lidhura me mësimdhënien.<br><br>*Aneksi Nr. 17; Aneksi 46* |
| **Kriteri 4.** Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit. | Raportet e vlerësimeve diskutohen në strukturat e universitetit duke filluar nga Departamenti deri në Senatin Akademik. Përmes përfaqësuesve të tyre, studentët njihen me këto raporte.<br><br>Ruajtja e raporteve dhe të dhënave kryhet nga NJBSC e cila mund të kryejë edhe analiza afatgjata të ecurisë së indikatorëve specifikë të cilësisë.<br><br>*Aneksi Nr. 37* |
| **Kriteri 5.** Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë | Raportet e paraqitura të vlerësimit nuk kanë analiza specifike mbi rezultatet e pritshme apo masat e marra. ***Sugjerohet që raportet të shoqërohen me rekomandime specifike, e më pas mbi to të hartohen plane veprimi, realizimi i të cilëve të vlerësohet në raportet pasardhëse.***<br><br>Gjithsesi, nga vizita në institucion u vu re se këto procese, megjithëse të padokumentuara në formën që kërkohen nga Kriteri 5, realizohen në punën e përditshme të strukturave të universitetit.<br><br>*Shënime gjatë vizitës* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi VI.3**<br>**Institucioni i arsimit të lartë përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programit të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni i arsimit të lartë e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo vetëvlerësimeve të brendshme periodike. | Vlerësimi i cilësisë së MSc ADU realizohet në mënyrë të vazhdueshme dhe është pjesë e punës rutinë të NJBSC. Në raportet e vlerësimit të brendshëm të programit të studimit si dhe në ato të vlerësimit institucional, argumentohen qartë dhe të shoqëruara me dokumentacion mbështetës proceset që ndiqen për këtë qëllim.<br><br>*RVB; Aneksi Nr. 37; Aneksi Nr. 46; Aneksi Nr. 8; Aneksi 17* |
| **Kriteri 2.** Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit. | Metodat e përdorura të vlerësimit janë përshtatur me natyrën e programeve të studimit në universitet, duke qenë se fushat e veprimtarisë akademike janë të ngjashme dhe komplementare. Përtej pyetësorëve dhe procedurave standarde të vlerësimit, Departamenti ndjek ecurinë e proceseve specifike që lidhen me mësimdhënien në MSc ADU. |
| **Kriteri 3.** Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera. | Vlerësimi i cilësisë akademike kryhet duke mbledhur opinionin e studentëve, duke realizuar vlerësime në auditor të personelit akademik nga kolegët, duke marrë parasysh vlerësimin e drejtuesve, dhe përmes vetëvlerësimit të personelit akademik. Kjo qasje mundëson një vlerësim të plotë dhe të hollësishëm të personelit akademik dhe aktivitetit të tyre në mësimdhënie.<br><br>Pesha e vlerësimit të studentëve llogaritet në 50% të vlerësimit të përgjithshëm të personelit akademik, ndërsa vlerësimi nga drejtuesit ka 35% të totalit.<br><br>*Analiza të tjera mbi vlerësimin e rezultateve dhe performancës së studentëve kryhen nga Departamenti, por raporte konkrete mbi këtë veprimtari nuk u evidentuan.*<br><br>*RVB, Aneksi Nr. 40; Aneksi Nr. 41* |
| **Kriteri 4.** Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e | Institucioni deklaron në RVB se ka një shumëllojshmëri instrumentesh e metodash të tërthorta vlerësimi që lidhen kryesisht me komunikimin e vazhdueshëm me studentin dhe ndjekjen e ecurisë akademike.<br><br>Gjatë vizitës u vu re se marrëdhënia me studentët dhe stafin ishte mjaft e afërt dhe e vazhdueshme, duke garantuar kështu komunikimin e vazhdueshëm dhe transparent. *Gjithsesi, nuk mundëm të evidentojmë dokumentim konkret të metodave apo instrumenteve të tërthorta të vlerësimit.*<br><br>*Shënime gjatë vizitës* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program | | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi VI.4**<br>**Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, stafin e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit. | Referuar rregullores së NJBSC, në përbërjen e njësisë janë të përfshirë personel akademik, administrativ, një anëtar nga studentët, një nga alumni dhe një nga biznesi / industria. Kjo përbërje garanton përfaqësimin e të gjitha grupeve të interesit.<br>*Aneksi Nr. 8* |
| **Kriteri 2.** Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave. | Brenda NJBSC rolet e anëtarëve janë specifike, ku përfaqësimi i strukturave jashtë universitetit kryhet nga dy anëtarë, ndërkohë anëtarët e tjerë mbulojnë të gjithë aktorët brenda universitetit (përfshirë edhe studentët).<br>Gjithashtu, pjesë e proceseve të sigurimit të cilësisë janë edhe Drejtuesi i Departamentit dhe koordinatori i programit të studimit të cilët kanë një rol aktiv për shkak të pozicionit të tyre.<br>Detyrat dhe përgjegjësitë në proceset e SBC janë të përshkruara në rregulloren e NJBSC, në rregulloren e Fakultetit dhe në rregulloren e përgjithshme të universitetit.<br>*Aneksi Nr. 5; Aneksi Nr. 6; Aneksi Nr. 8* |
| **Kriteri 3.** Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit. | Në përputhje me dokumentet e përmendur në Kriterin 2 të këtij standardi rezulton se:<br>- Senati Akademik vlerëson dhe garanton aktivitetet për sigurimin e brendshëm të cilësisë<br>- Rektori është përgjegjës dhe organizon punën për sigurimin e brendshëm të cilësisë<br>- Rektorati shqyrton rezultatet e raporteve të vlerësimit vjetor të cilësisë.<br>- Departamenti propozon programet e studimit, si edhe numrin e studentëve për çdo program, në përputhje me kapacitetet akademike dhe infrastrukturore të tij, sipas standardeve të cilësisë. |

| | |
|---|---|
| | Referuar rregullores së NJBSC, përfaqësimi i anëtarëve të personelit akademik, administrativ dhe studentëve është e garantuar.<br><br>*Aneksi Nr. 5; Aneksi Nr. 6; Aneksi Nr. 8* |
| **Kriteri 4.** Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve. | Nga vizita në institucion u vu re një atmosferë gjithëpërfshirëse, pa paragjykime dhe diskriminim, ku komunikimi institucional dhe individual respektonte normat etike dhe akademike.<br><br>*Shënime gjatë vizitës* |
| **Kriteri 5.** Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj | Kontakti i vazhdueshëm i personelit akademik me ekspertë të huaj apo institucione partnere në kuadër të bashkëpunimit akademik e atij kërkimor shkencor ka shërbyer për përthithjen e eksperiencave pozitive që kanë ndihmuar në zhvillimin e përgjithshëm të institucionit. Këto kontakte, si pjesë e veprimtarisë normale në një institucion akademik ndihmojnë në mënyrë direkt apo indirekt edhe në proceset e SBC. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi VI.5**<br>**Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit. | Veprimtaria e lidhur me SBC përmblidhet në raportin vjetor të NJBSC. Gjetjet e raportit janë të aksesueshme brenda institucionit nga personeli akademik dhe përfaqësuesit e studentëve. Gjetjet dhe raporti diskutohen edhe në njësitë përkatëse dhe në Senatin Akademik.<br><br>*GVJ vlerëson se ekziston transparenca e brendshme, por konstaton se gjetjet nuk janë lehtësisht të arritshme jashtë institucionit.* ***Sugjerohet publikimi online i raportit vjetor të NJSBC ku të dhënat e përgjithshme mund të qasen nga një publik i gjerë dhe nga çdo student.*** |
| **Kriteri 2.** Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale. | Raporti vjetor i NJSBC që na është vënë në dispozicion së bashku me RVB nuk ekspozon të dhënat personale dhe nuk cenon lirinë akademike.<br><br>GVJ vlerëson se të dhënat e raportit janë mjaft të vlefshme për informim, por konstaton se gjetjet nuk janë të publikuara. Sugjerohet publikimi online i raportit vjetor të NJSBC ku të dhënat e përgjithshme mund të aksesohen nga një publik i gjerë dhe nga çdo student. |
| **Kriteri 3.** Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë | RVB përshkruan procesin e analizimit të gjetjeve të vlerësimit të brendshëm të cilësisë të cilat konkludojnë me një plan masash që ndiqen deri në zgjidhjen e problematikave të konstatuara. ***GVJ nuk ka në*** |

| | |
|---|---|
| përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara. | ***dispozicion dokumentacion konkret që evidenton këtë proces dhe sugjeron hartimin e rekomandimeve dhe planeve të veprimit si pjesë e raportit vjetor të NJBSC ose si dokument më vete.*** <br><br> Shih edhe Standardi VI.2 Kriteri 5 |
| **Kriteri 4.** Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit. | Sistemi i brendshëm i sigurimit të cilësisë vlerësohet i efektshëm dhe mundëson zhvillimin cilësor të programit të studimit. Proceset e akreditimeve gjithashtu ndikojnë në vlerësimin objektiv në përputhje me Kodin e Cilësisë dhe në formulimin e rekomandimeve për përmirësim të mëtejshëm të cilësisë akademike. |
| **Kriteri 5.** Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit | Referuar RVB dhe takimit me NJBSC, rezulton se njësia është aktive dhe ka kontakte të vazhdueshme me studentët, sidomos në kuadër të organizimit të pyetësorëve dhe në informimin mbi proceset e akreditimit. <br><br> Informimi i personelit akademik kryhet edhe nga Departamentit apo organet e tjera të universitetit. <br><br> Përgjithësisht, u vu re një shkallë e mirë ndërgjegjësimi mbi proceset e SBC ku vihet re angazhimi aktiv i universitetit në këtë drejtim. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | **X** | |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave i Integruar në "Arkitekture dhe Dizajn Urban" "Universiteti POLIS"**

**Pikat e forta dhe afirmime**

1. Organizimi i trajnimeve të ndryshme institucionale për pedagogët dhe studentët.
2. Numri i madh i Marrëveshjeve të bashkëpunimeve të U_POLIS me institucionet tjera.
3. Biblioteka e IAL-së përveç materialeve fizike sasiore me libra, materiale fizike të printuara si dhe elektronike që ju përkasin fushave profesionale të programeve të studimeve, ofron edhe bibliotekë elektronike e-library të nivelit ndërkombëtar sikur EBSCO dhe JSTOR.
4. Laboratorë të avancuara
5. Institucioni ka krijuar një traditë vlerash në rekrutimin e personelit dhe angazhimin e tij, çfarë konfirmohet me produkte të certifikuara në tregun e punës
6. Programi i studimi mbështetet nga personel akademik me nivel të lartë profesional, i cili përmbush të gjitha detyrimet kontraktuale dhe realizon objektivat e zhvillimit të universitetit. Personeli akademik ka evidentuar zotësi në realizimin e programeve të bashkëpunimit me universitetet partnere dhe cilësi në botimet e referimet e përbashkëta.
7. U_POLIS motivon personelin e angazhuar në programin mësimor "MSc në Arkitekture dhe Dizajn Urban" përmes krijimit të një mjedisi akademik të hapur, ndërkombëtar dhe konkurrues. Studentët e këtij institucioni dhe posaçërisht ata të PS "MSc në Arkitekture dhe Dizajn Urban", kanë në dispozicion të gjitha shërbimet për t'u informuar në kohë e me cilësi. Ata ndjehen të lidhur me tregun e punës dhe të sigurtë për ta kapur atë.
8. U_POLIS gëzon një imazh të mirë për aktivitetin e tij, të fituar edhe nëpërmjet akreditimeve (akreditimet institucionale dhe ato të programeve të studimeve).

**Pika të dobëta**

1. Feetback-u i pa evidentuar nga tregu i punës, për nevojat e përmirësimit eventual të lëndëve, kurrikulës të programit të studimit MSc i Integruar në "Arkitekturë dhe Dizajn Urban".
2. Numri i lëndëve mësimore me zgjedhje të programit të studimit është i vogël dhe nuk shkojnë më së miri me profilet, përkatësisht me kompetencat.
3. Mbingarkesa në orë në auditor e një pjese të personelit akademik.
4. Realizimi i një pjese të ngarkesës në auditor në vitin e katërt dhe të pestë nga personel akademik me nivelin e kualifikimit Master i Shkencave.

**Rekomandime**

1. Të merret dhe të konsiderohet më mirë feetback-u nga tregu i punës, për të përmirësuar/ndryshuar përmbajtjen e lëndëve mësimore si dhe formatin e lëndëve me zgjedhje.
2. Të mbështetet rritja e nivelit të kualifikimit të personelit akademik, duke garantuar zhvillimin e ngarkesës mësimore me personel me kualifikimin përkatës (minimalisht me gradën shkencore Doktor në vitin e katërt dhe të pestë). Mbështetur në trendin rritës të studentëve të regjistruar në këtë program studimi, institucioni të rrisë kapacitetet duke rekrutuar staf të ri akademik.

3. Të reduktohet ngarkesa e personelit akademik që në disa raste tejkalon 600 orë në auditor në vit dhe mbi 10 lëndë / module të ndryshme.
4. IAL te zhvillojë mundësinë e sistemit te komunikimit te brendshëm me qellim ruajtjen e dokumentacionit, vendimet e njësive dhe korrespondencat mes tyre.
5. Rezultatet e vlerësimit të brendshëm të cilësisë të jenë publike dhe të pasohen me procese të vazhdueshme që nxisin rritjen e mëtejshme të cilësisë.

## Conclusions of the Evaluation of the study program of the second cycle Integrated Master of Science in "Architecture and Urban Design" "POLIS University"

### Strengths and affirmations

1. Organizing various institutional trainings for professors and students.
2. Numerous Memorandums and collaborations of U_POLIS with other institutions.
3. The HEI library, in addition to quantitative physical materials with books, printed physical materials and electronics that belong to the professional fields of study programs, also offers an electronic e-library of international level such as EBSCO and JSTOR.
4. Advanced laboratories
5. The institution has established a tradition of values in staff recruitment and engagement, which is confirmed by certified products in the labor market.
6. The study program is supported by academic staff with a high professional level, who fulfills all contractual obligations and achieves the development objectives of the university. The academic staff has demonstrated ability in the implementation of cooperation programs with partner universities and quality in joint publications and references.
7. U_POLIS motivates the staff engaged in the "MSc in Architecture and Urban Design" program through the creation of an open, international and competitive academic environment. The students of this institution and especially those of the study program "MSc in Architecture and Urban Design", have all the services available to be informed in a timely and quality manner. They feel connected to the job market and confident to capture it.
8. U_POLIS enjoys a good image for its activity, gained also through accreditations (institutional accreditations and those of study programs).

### Weak points

1. Missing feetback from the labor market, for the eventual demands of course's improvement, and improvement of the curriculum of the integrated MSc in "Architecture and Urban Design".
2. The number of elective courses of the study program is small and does not fit best the profiles with the competencies.
3. Overload in class hours for some of the academic staff.
4. Realization of a part of the teaching load in the fourth and fifth year by academic staff with the level of qualification "Master of Science".

**Recommendations**

1. Obtain and better consider the feedback from the labor market, to improve / change the content of the courses as well as the format of the elective courses.
2. To support the further qualification of the academic staff, guaranteeing the fulfillment of the teaching load with staff with the respective qualification (minimum with PhD degree in the fourth and fifth year). Based on the growing trend of students enrolled in this study program, the institution should increase its capacities by recruiting new academic staff.
3. To reduce the teaching load of academic staff that in some cases exceeds 600 class hours per year and over 10 subjects / modules.
4. HEI should develop an internal communication system in order to preserve documentation, decisions of units and correspondence between them.
5. The results of the internal quality assessment should be public and followed by continuous processes that promote further quality improvement.

**Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit**

| FUSHAT E VLERËSIMIT | SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS | | | |
|---|---|---|---|---|
| | [redacted] | Përmbushen pjesërisht | Përmbushen kryesisht | Përmbushen plotësisht |
| I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT | | | | X |
| II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT | | | | X |
| III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT | | | | X |
| IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT | | | | X |
| V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE | | | | X |
| VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE | | | | X |
| VLERËSIMI TËRËSOR | | | | X |